

# GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI  
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA  
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7644 E premte 7 Shtator 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion

Ditës

Nga XHEVAT MUSTAFA

## Politika shqiptare, "minierë rastësish"



Dje

në "Deutsche Welle"

Nga VOLKER WAGENER

## Kosovarët e serbët vendosin duart në hartë

Lista e rastësive që kanë lidhje të forhtë, mesatare apo të paktë me politikën dhe qeverisjet shqiptare në këta afro 106 vjet pavarësi dhe shtet është e pafundme ...  
Vijon në faqen 20

Paprekshmëria e kufijve janë kompleti më i shtrenjtë i së drejtës europiane shtetërore. Kufijtë janë të shenjtë. Kështu thuhet, se në Bosnje-Hercegovinë ...  
Vijon në faqen 21



Policia: Dyshohet si grup kriminal

## "Forca e ligjit", Ilir Bajri dhe ish-kampioni i boksit në pranga

Operacioni në Shkodër, 4 veta të arrestuar. Sekuestrohen armë dhe 6 mjete të blinduara

SHKODËR - Një ditë pas operacionit të zhvilluar në lagjet "Kiras" dhe "Dobraç" të qytetit të Shkodrës, Policia e Shtetit ka bërë publikë emrat e katër personave të arrestuar. Mes të arrestuarve është një nga fisi Bajri dhe konkretisht 42-vjeçari Ilir Rustemi (Bajri), i njohur si autor i disa veprave kriminale si dhe ish-kampioni ...  
Në faqen 3

## EMRAT/ MINISTRIA E FINANCAVE: 200 TRASHEGIMTARËT QË MARRIN PARATË

# TE PERNDJEKURIT, KUSH E PERFITON KESTIN E DYTE

Ish-të dënuarit e diktaturës që marrin paratë. Kush e ka emrin në listë duhet të dorëzojë numrin e llogarisë bankare brenda 3 muajsh



(Në foto) Ish-të përndjekur në protestë

Në faqen 9

BASHA Mbledhë Firmat

PD shpall nismën: Veting politikës.

Rama konfirmon: Ta bëjmë sa më parë

Në faqet 4-5

KRYETARJA E LSI

Kryemadhi: Me Berishën i frytshëm bashkëpunimi, Rama ngre kurthe

Në faqen 7

KOSOVE-SERBI

Sot takon Vuçiçin, Thaçi: Marrëveshje, nëse Serbia na njeh si shtet

Në faqen 22

INTERVISTA

Zv.ministri i Arsimit, Shpati Kolgega: Sfidat i japin kuptim jetës

Suplement

MEMALIAJ



Denoncoi parcelat e hashashit në polici, vritet me plumb pas koke 43-vjeçari

Në faqen 12

Tronditet Mamurrasi, policia: Dyshimi, hakmarrje për plagosjen e 2012-ës

## Ekzekutohet 27-vjeçari në derë të shtëpisë

Identifikohet autori i krimit, shpallet në kërkim Azis Markola

MAMURRAS-Tronditet Mamurrasi. Pa kaluar as 24 orë nga vrasja me thikë e një 14-vjeçari, një tjetër ngjarje tjetër e rëndë ka shokuar banorët e zonës. Indrit Pepa është ekzekutuar me breshëri automatiku në derë të shtëpisë. Burime zyr-



tare nga policia bënë me dije se i riu u vra në orët e para të mëngjesit të djeshëm afër xhamisë, në lagjen "Zef Hoti" (periferi të Mamurrasit). Mënyjëherë në vendngjarje kanë shkuar blutë, të cilët kanë nisur hetimet ...  
Në faqen 12

## "FORCA E LIGJIT" HETIMET

Policia: Arjan Ndoci dhe Julian Deblini u kapën më 30 prill me 1 ton kokainë

# U arrestuan në Spanjë, policia shqiptare i bllokoi 5 mln euro pasuri

Dyshohet se paratë janë fituar nëpërmjet drogës

Policia e Shtetit dhe Prokuroria e Krimeve të Rënda kanë sekuestruar 5 milionë euro pasuri të një grupi kriminal shqiptar. Bëhet fjalë për pasuritë e shtetasve Arjan Ndoci dhe Julian Deblini të arrestuar më 30 prill në Spanjë për trafikim ndërkombëtar të lëndëve narkotike nga Amerika Latine në vendet e Europës. Falë një operacioni të përbashkët të autoriteteve të sipërpërmendura, bëhet me dije se janë bllokuar llogari bankare të shtetasve të mësipërm dhe të familjarëve të tyre, si dhe pasuritë të patundshme, të tilla si apartamente e biznese. Dyshohet se Ndoci dhe Deblini paratë e fituara nëpërmjet veprimtarisë kriminale i kanë investuar në disa qytete të vendit, kryesisht në Tiranë. Policia e Shtetit në bashkëpunim me Prokurorinë e Krimeve të Rënda dhe agjencitë ligjzbatuese amerikane dhe spanjolle po vijojnë veprimet për identifikimin e personave të tjerë të përfshirë në këtë aktivitet kriminal si dhe për pasuritë të tjera, të luajtshme apo të paluajtshme, llogari bankare, të dyshuara me prejardhje kriminale në shtete të ndryshme ku është zhvilluar ky aktivitet kriminal.

### ARRESTIMI

Më datë 30 prill 2018, autoritetet policore spanjolle në bashkëpunim DEA dhe EUROPOL kanë arrestuar në flagrancë shtetasit shqiptarë, Arjan Ndoci 41 vjeç, lindur dhe banues në Lac, Kurbin, i njohur ndryshe edhe me emrat Dritan Gradica, Ardjan Noka, Mondi Prenga, Mond Gjoni, Don Gjoni, Julian Deblini (Bedlini), 35 vjeç, lindur dhe banues në Lezhë. Ata akuzohen për veprën penale të "Trafikimit ndërkombëtar të lëndëve narkotike", pas kapjes së një sasive prej 1.000 kg kokainë, e cila dyshohet se vinte nga Kolumbia si dhe të një shume prej 1.550.000 Euro 'cash'. Këta 2 shtetas



Droga e sekuestruar në Spanjë

### OPERACIONI

Policia e Shtetit dhe Prokuroria e Krimeve të Rënda falë një operacioni të përbashkët kanë sekuestruar 5 milionë euro pasuri të shtetasve Arjan Ndoci dhe Julian Deblini, të arrestuar më 30 prill në Spanjë, për trafikim ndërkombëtar të lëndëve narkotike nga Amerika Latine në vendet e Europës. Konkretisht, bëhet me dije se janë bllokuar llogari bankare të shtetasve të mësipërm dhe të familjarëve të tyre, si dhe pasuritë të patundshme, të tilla si apartamente e biznese.

Kontrolle në vendin e quajtur "Kthesa e Poshnjes", "Kombinat", "Uznovë"

## Policia nis aksionin në qytetin e Beratit, në sitë mjetet me xhama të zinj

Pas Shkodrës e Elbasanit, forca të shumta policie kanë zëbarkuar edhe në një qytet tjetër, në Berat. Ndonëse Berati nuk renditet ndër qarqet më problematike për sa i përket ngjarjeve kriminale të kësaj vere, edhe në këtë qytet policia ka intensifikuar kontrollet në goditje të individëve, apo grupeve kriminale. Eftë-



tivët e sektorëve të rendit të Policisë Rrugore kanë zhvilluar sot kontrollet të

janë anëtarë të një grupi kriminal që zhvillonte prej kohësh trafik të lëndëve narkotike nga vendet e Amerikës Latine në drejtim të Europës. Menjëherë pas realizimit të këtij operacioni nga autoritetet e sipërpërmendura, Policia e Shtetit ka shkëmbyer informacione paraprake për identifikimin e shtetasve dhe pjesëtarëve të tjerë të këtij grupi kriminal si edhe asetet e përfituara nga veprimtaria e

paligjshme. Pas kryerjes së veprimeve paraprake nga Departamenti i Policisë Kriminale, materiali procedural u referua nga Policia e Shtetit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë dhe u regjistrua procedurali penal nr.85, viti 2018, për veprat penale të "Grupit të strukturuar kriminal", "Trafikim ndërkombëtar të lëndëve narkotike" dhe "Pastrimit të produkteve të

detajuara në shumë akse të qytetit, ku në fokus janë vënë mjetet me xhama të zeza, ku janë kontrolluar fizikisht drejtuesit, mjetet dhe dokumentacionet e tyre. Aksione janë zhvilluar në vendin e quajtur "Kthesa e Poshnjes", "Kombinat", "Uznovë". Aksionet vijojnë ende, ndërkohe që policia e Beratit do të japë së shpejti rezultatet e tij.

veprës penale apo veprimtarisë kriminale", në ngarkim të shtetasve Arjan Ndoci dhe Julian Deblini (Bedlini).

### HETIMI

Nga kryerja e veprimeve hetimore u ngritën dyshime të arsyeshme se këta shtetas, kanë kryer veprime intensive procedurale, duke përdorur metoda speciale të hetimit dhe pajisje speciale për grumbullimin e provave materiale. Në përfundim të veprimeve hetimore të kryera në terren u siguruan prova të pakontestueshme dhe Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda vendosi sekuestro preventive për llogaritë bankare dhe



Aksioni i policisë në Shkodër

### PASURIA E SEKUESTRUAR

- Llogarive bankare me një sasi të konsiderueshme eurosh në 3 banka të nivelit të dytë.
- Kuotat dhe aksionet e një shoqërie tregtare me aktivitet në fushën e ndërtimit.
- Një njësi banimi në pallat.
- Tetë apartamente, me një sipërfaqe ndërtimi 905 metra katrorë.
- Dy njësi tregtare (dyqane) me një sipërfaqe prej 280.4 metra katrorë.
- Katër garazhe me sipërfaqe në total 60 metra katrorë.
- Tre automjete të tipave dhe llojeve të ndryshme.

dhe për familjarët e tyre dhe në disa raste, duke i fshehur ato në emrat e të afërmeve. Konkretisht, investimet i kanë bërë në disa qytete të vendit, kryesisht në Tiranë. Gjatë kryerjes së veprimeve hetimore janë zhvilluar disa takime të përbashkëta operacionale me përfaqësues të Zyrës Rajonale të DEA Athinë, DEA Madrid, autoritete policore spanjolle dhe EUROPOL, në kuadër të shkëmbimit në kohë reale dhe identifikimin e personave të tjerë të përfshirë në këtë aktivitet kriminal. Gjatë gjithë kësaj periudhe, oficerët e Policisë Kriminale të Policisë së Shtetit, nën drejtimin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, kanë kryer veprime intensive procedurale, duke përdorur metoda speciale të hetimit dhe pajisje speciale për grumbullimin e provave materiale. Në përfundim të veprimeve hetimore të kryera në terren u siguruan prova të pakontestueshme dhe Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda vendosi sekuestro preventive për llogaritë bankare dhe

pasuritë të luajtshme dhe të paluajtshme të shtetasve Arjan Ndoci, Julian Deblini (Bedlini) dhe familjarëve të tyre.

Ditën e djeshme, oficerët e Task Forcës Speciale në Departamentin e Policisë Kriminale në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit ekzekutuan Vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda pranë 3 bankave të nivelit të dytë, të disa llogarive bankare me një sasi të konsiderueshme eurosh. Kuotat dhe aksionet e 1 shoqërie tregtare me aktivitet në fushën e ndërtimit, 1 njësi banimi në pallat, 8 apartamente me një sipërfaqe ndërtimi 905 metra katrorë, 2 njësi tregtare (dyqane) me një sipërfaqe prej 280.4 metrash katrorë, 4 garazhe sipërfaqe 60 metra katrorë, 3 automjete të tipave dhe llojeve të ndryshme. Shuma e asetëve të sekuestruara në kuadër të operacionit, e përllogaritur me çmimin e tregt kap vlerën prej 5 milionë eurosh. Ndërkohë bëhet me dije se po vijojnë veprimet për identifikimin e personave të tjerë të përfshirë në këtë aktivitet kriminal.



SHKODËR

Një ditë pas operacionit të zhvilluar në lagjet "Kiras" dhe "Dobraç" të qytetit të Shkodrës, Policia e Shtetit ka bërë publike emrat e katër personave të arrestuar. Mes të arrestuarve është një nga fisi Bajri dhe konkretisht 42-vjeçari Ilir Rustemi (Bajri), i njohur si autor i disa veprave kriminale si dhe ish-kampioni i boksit, Astmer Bilali. 29-vjeçari dyshohet të ketë qenë shënjestra e sulmit, ku mbeti i vrarë biznesmeni Arjan Ferracaku. Ndërkohë, mësohet se gjatë operacionit, i cili nisi në orën 02:30 të mëngjesit të së mërkurës kanë përfunduar në pranga dhe shtetasit: Emrah Plaku, 22 vjeç dhe Erogen Brajoviç, 36 vjeç nga Shkodra. Ky i fundit është një emër i njohur në Shkodër për shkak se ka qenë anëtar i këshillit bashkiak (përfaqësues i Partisë Bashkimi për të Drejtat e Njeriut. Në vitin 2007-të ai është akuzuar për veprën penale të "shtrëngimit me anë të kanosjes ose dhunës për përfitim të pasurisë". Ndërkaq, në operacionin e ditëve më parë është shpallur në kërkim një tjetër. Sipas bluve, ky operacion u ndër mor për zbulimin dhe kapjen e grupeve kriminale, të cilat dyshohen se janë autorë të disa ngjarjeve të rënda, të ndodhura gjatë tre muajve të fundit në këtë qytet. Bazuar në 19 urdhra kontrolli të miratuar me vendim gjykatë, Policia e Shtetit ushtroi kontrolle në 20 banesa e lokale tregtare, të përdorura prej personave të dyshuar si anëtarë të grupeve kriminale. Nga kontrollet e ushtruara janë sekuestruar armë, municione, mjete të blinduara dhe sende të tjera të poseduara në mënyrë të paligjshme.

PERSONAT ARRESTUAR

1. Ilir Rustemi (Bajri), 42 vjeç, lindur e banues në "Dobraç", Shkodër.
2. Emrah Plaku, 22 vjeç, lindur e banues në Shkodër.
3. Astmer Bilali, 29 vjeç, lindur e banues në Shkodër.
4. Erogen Brajoviç, 36 vjeç, lindur e banues në Shkodër.

PROKURORIA

Në lidhje me operacionin e zhvilluar në qytetin verior ka reaguar dhe prokuroria. "Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër ka vijuar hetimet intensive për identifikimin e autorëve të krimeve të rënda që kanë ndodhur në qytetin e Shkodrës në muajt e fundit. Mbi bazën e dyshimit të arsyeshëm të deduktuar nga provat e administruara deri në këtë moment procedural i paraqitëm gjykatës kërkesën për të lejuar kontrollin e banesave dhe vendeve të tjera, në të cilat mund të gjendeshin prova me rëndësi për hetimin", thuhet mes të tjerash në njoftimin e organit të akuzës.



Policia: Dyshohen të jenë anëtarë të grupeve kriminale, kontrolluam 20 banesa e lokale

# Vrasjet e bujshme në Shkodër, ja 4 të "fortët" që përfunduan në pranga

## Mes të arrestuarve, Ilir Bajri dhe ish-kampioni i boksit, Astmer Bilali



Arrestimet e kryera gjatë operacionit në Shkodër



Ish-kampioni i boksit, Astmer Bilali

Policia: Ja krimet e kryera ndër vite nga 42-vjeçari

## Kush është i "tmerrshmi" i Shkodrës, Ilir Bajri

SHKODËR - Mediat online shkruajnë se një nga personat që u vunë në pranga nga policia dhe forcat speciale është dhe i "forti" i Shkodrës, Ilir Rustemi (Bajri). Sipas bluve, 42-vjeçari rezultoi të jetë autor i disa krimeve bashkë me të vëllanë Behar Bajri dhe i dyshuar në disa të tjera. Sipas Policisë së Shtetit:

**Më datë 14.01.1999** në lagjen "Dobraç" të qytetit të Shkodrës, Behar Bajri, Ilir Bajri dhe Frederik Totaj në bashkëpunim me njëri-tjetrin dyshohen se kanë kryer veprën penale të vjedhjes me armë ndaj dy qytetarëve nga Berati, të cilët kanë qenë duke udhëtuar me një automjet tip kamion me targë të Vlorës.

**Më datë 14.01.1999** në lagjen "Vojo Kushi" janë vrarë me armë zjarri vëllezërit Osman e Artur Alibali. Autorë të dyshuar të kësaj ngjarjeje kanë rezultuar të jenë shtetasit Behar Bajri, Ilir Bajri dhe Frederik Totaj.

ndalojnë dje (të mërkurën) në qytetin e Shkodrës disa elemente me rrezikshmëri shoqërore të lartë, anëtarë të grupeve kriminale aktive në këtë territor, por edhe me gjerë", thuhet në njoftimin zyrtar të policisë. Sipas burimeve të mësipërme, hetimet



Kjo vrasje është kryer menjëherë mbas vjedhjes me armë të kryer ndaj dy shtetasve nga Berati.

**Më datë 21.03.1999** Behar Bajri në bashkëpunim me shtetasin Ilir Bajri kanë tentuar të kryejnë vjedhje me armë ndaj Arben Tuzit dhe vëllait të tij. Nga sh-

këmbimi i zjarrit të dyja palët kanë plagosur njëri-tjetrin.

**Më datë 15.02.2001** në lagjen "Vasil Shanto" të qytetit të Shkodrës është vrarë me armë zjarri shtetasi Arben Tuzi, vjeç 39 nga Shkodra. Autorët e dyshuar të kësaj ngjarjeje kanë

dhe sa më të qartë të veprimitarisë kriminale të personave të dyshuar për kryerjen e kësaj veprimtarie. Në operacionin e zhvilluar në Shkodër janë sekuestruar nga policia: 3 armë zjarri, (2 kalashnikovë dhe 1 pistoletë),

rezultuar të jenë shtetasit Behar Bajri dhe Ilir Bajri.

**Më 4 gusht të vitit 2006**, Ilir Bajri Ilir akuzohet se ka vrarë Pal Kosterin, pranë banesës së tij, në fshatin Stom-Golem, pak metra larg Urës së Bardhë. Vrasja pati ndodhur pas një konflikti të dy autorëve me dy nga djemtë e viktimës, që janë pronarë të një lokali në Velipojë. Autori kishte frekuentuar lokalitë në Velipojë dhe në gjendje të pirë ka shkakuar trazira në të. Kjo ka bërë që pronarët, djemtë e viktimës t'i kërkojnë Bajrit të mos vinte më në lokalitë e tyre, pasi po u largoheshin klientët. Nga kjo, autori është ndjerë i fyer dhe ka shkuar në Shkodër, tek shtëpia e Pal Kosterit dhe pasi e ka thirrur atë të dalë jashtë, e ka qëlluar me armë. Bashkëshortja e viktimës i ka identifikuar autorët, të cilët i njihje edhe më parë.

6 mjete të blinduara, rreth 800 fishekë, 1 armë e ftohtë, 10.500 euro, 3 makina lojërash fati, njësi kompjuterike, DVR, CD dhe USB, telefona celularë dhe karta telefonike dhe 2 veshje anti-plumb.

# KRIMINALITETI REAGIMET

Kryeministri: Policia flet me vepra, opozita bën politikë me krimin

## Rama: Veting politikanëve sa më parë, ta diskutojmë me PD

"Bashkëqeverisja, kryebashkiakët në këmbë si ministrat"

Darina Tanushi

Kryeministri Edi Rama shprehu dje gatishmërinë për të nisur sa më parë vetingun edhe për politikanët, ndërsa u shpreh i hapur që të diskutojë me Partinë Demokratike. Pas propozimit të bërë nga kreu i PD-së, Lulzim Basha, kryeministri shkroi në rrjetin social "Twitter": "Veting politikanëve? Sa më parë! Me një drejtësi të pas-truar përmes vetingut, s'do ketë më as në këtë vend sh-teg për politikanët që t'i ikin drejtësisë. Dhe çdo ide tjetër për të rritur llogaridhënien e politikanëve është e mirëseardhur. Gjithnjë gati të diskutojmë me PD". Ndërkohë, në një tjetër postim, Rama publikoi edhe grafikë me shifrat e kriminalitetit. "E vërteta e shifrave të krimit dhe rezultateve në vite të policisë në Shkodër flet qartë, paqka se s'çan dot në tregun mediati-k. Sot Policia e Shtetit ka folur përsëri me vepra. Me llafet e kujt ikën nga Kuvendi për të bërë politikë me krimin qytet më qytet s'ia vlen të merresh", u shpreh Rama duke nënkuptuar akuzat dhe veprimet e opozitës.

### SHKARKIMI

Po dje kryeministri Edi Rama, nisur edhe nga ankesat e qytetarëve për zvarritje të çështjeve që lidhen me pronësinë në Fier, urdhëroi shkarkimin e drejtorit të Hipotekës së Fierit. Lajmin e bëri të ditur vetë kryeministri Rama në takimin e përjavshëm me koordinatorët e bashkëqeverisjes në Sallën e Hartave. Vetëm në këtë takim u paraqitën 3 raste të ankesave të qytetarëve për çështje të pajzgjdhura në Hipotekën e Fierit. Njëri prej rasteve kishte të bënte me ankesën e një 77-vjeçari, i cili nuk



Kryeministri Edi Rama

### Vetingu për politikanët, Braçe: Jo për të mbyllur hallet e Bashës me drejtësinë

Deputeti i Partisë Socialiste, Erjon Braçe deklaroi se vetingu për politikanët duhet të bëhet sa më shpejt, por nëse legjitimiteti mos gjykonim e Lulzim Bashës për akuzën e prokurorisë për abuzimet me rrugën Rrëshen-Kalimash, apo vrasjen e katër shqiptarëve në 21 janar, vetingu do jetë një tallje e madhe. Braçe tha se, "veting për politikanët? Me qejfën më të madh të mundshëm sa më shpejt! Por, jo për të zgjidhur hallet e Lulzim Bashës, as për të mbyllur hallet e tij me drejtësinë! Shqip - shton Braçe duke vijuar - nëse vetingu legjitimitet mosgjykonim e Lulzim Bashës për akuzën e ligjshme, të provuar nga prokuroria për abuzimet në prokurimin e rrugës Rrëshen-Kalimash; nëse vetingu legjitimitet mosgjykonim e Lulzim Bashës për akuzën e vrasjes së katër shqiptarëve të paarmatosur në mes të bulevardit, atëherë ai do të jetë një tallje e madhe e përsëritur me shqiptarët!".

pajisje me certifikatën e pronësisë së tokës bujqësore, edhe pse kishte ndjekur të gjitha hallkat administrative. 77-vjeçari atë pasuri e kishte marrë në mënyrë të ligjshme dhe don-të t'ia linte trashëgim së bijës. Në tetor 2017, ai aplikoi pasi kishte mbyllur të gjitha procedurat në Bashkinë Roskovec. Iu drejtua ADISA-s,

por edhe pse plotësoi dokumentacionin e kërkuar, çështja vijoi të zvarritej nga hipoteka. Pas ankesës në platformën e bashkëqeverisjes, ai u pajis me certifikatën e pronësisë. "Platforma e bashkëqeverisjes na ndez 'lambat e kuqe' aty ku duhet të ndërhyjmë. Fakti që qytetarët thonë kam 6-7 muaj, apo 1 vit, është e mjaft-

### GAZMEND BARDHI

Ish-ministri i Drejtësisë, Gazment Bardhi, tha dje se: "Edi Rama refuzon vetingun e politikanëve! Kjo provon se ka lidhur pushtetin e tij me krimin e organizuar! Si në çdo rast ku është në vështirësi, edhe sot thirrri në ndihmë drejtësinë e korruptuar e të kontrolluar politikisht prej tij".

tueshme në këtë aspekt", - tha Rama, duke shtuar se platforma e bashkëqeverisjes nuk është thjesht një slogan, por është realitet. Në takimin me koordinatorët e bashkëqeverisjes, kryeministri Edi Rama ka përsëritur paralajmërimin për kryetarët e bashkive dhe drejtorët e institucioneve që nuk përgjigjen ndaj ankesave të qytetarëve. Rama ka thënë se çdo kryetar bashkive duhet të përgjigjet për çdo ankesë, njësoj si çdo ministër, që sipas tij raportin me përgjegjshmëri për detyrën e tij. "Do detyrohem të nisim me emra e mbiemra nëse bashkitë nuk fillojnë të përgjigjen. Nëse edhe sot në vitin 2018 i ndajnë qytetarët në të ardhur dhe të tyret e s'duan t'ia dinë fare apo për inat të bashkëqeverisjes ua faturonjë fajin qytetarëve, kjo është fatkeqësi. Të marrim masat, t'u përgjigjen platformës, ose do i nxjerrim me emër e mbiemër bashkë me rastet kur nuk u kanë dhënë ndihmë qytetarëve. Çdo kryetar bashkive duhet të ngrihet në këmbë ashtu siç ngrihet çdo ministër. Këtu bëhet nami, çdo ministër raporton për ecurinë e punës, me përgjegjësi të plotë", tha Rama.



### Balla i përgjigjet Spahos: Rama dakord, takohemi bashkë për vetingun

Kreu i grupit parlamentar i Partisë Socialiste, Taul Balla reagoi pas postimit në "Facebook" të Edmond Spahos, i cili deklaronte se, "refuzimi i Edi Ramës për vetingun me ligj të politikanëve provoi se Rama është peng i krimit". "I dashur Mondit, lexova reagimin tënd ku akuzoj Ramën që ka refuzuar këtë të vetingut! U habita e desha të pyes njëherë se mos është lajm i rremë, se Rama e tha qartë që jemi shumë dakord. Madje, ai më ngarkoi mua të komunikoj nesër me ty për të mësuar më shumë mbi idenë që keni për këtë nismën e vetingut të politikanëve. Sepse nga teksti nuk kuptohej asgjë konkrete si e ka idenë Luli, madje më shumë dukej si tekst kundër reformës në drejtësi se sa për thellimin e vetingut. Ne nga ana jonë jemi gati dhe jam në dispozicion", u shpreh Balla.



### EDMOND SPAHO

"Refuzimi i Edi Ramës për vetingun me ligj të politikanëve provoi se Rama është peng i krimit! Kryeministri i krimit po përdor drejtësinë e tij dhe mediati e tij për të mashtuar shqiptarët. Edi Rama e refuzon vetingun me ligj të politikanëve, sepse vetë ka lidhje me kokat kryesore të krimit të organizuar", u shpreh dje nënkryetari demokrat, Spaho.

### PS mbledh sot asamblenë, nuk diskutohen ndryshime në qeveri

Socialistët mbledhin sot Asamblenë Kombëtare, e cila do të fokusohet në përgatitjen për nisjen e fushatës për zgjedhjet vendore të vitit që vjen. Burimet bëjnë me dije se nuk pritet që nga kreu i partisë, Edi Rama të bëhet publikë ndonjë ndryshim ministri në kabinetin e tij, të paktën jo në mbledhjen e sotme. Mbledhja do të nisë me raportin e Llogaridhënies Publike të Qeverisë "Puna për Shqipërinë që duam". Më pas sipas axhendës së publikuar do të jetë një raport i grupit të Punës të Asamblesë Kombëtare të Partisë: "Mbi performancën e përfaqësuesve të Partisë Socialiste në qeverisjen vendore". Ndërkohë që do të miratohen edhe një udhëzim për fillimin e procedurave për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Këshillave Bashkiake për zgjedhjet vendore 2019 apo udhëzimi për ngritjen e strukturave koordinuese elektorale për zgjedhjet vendore 2019. Mbledhja e cila do të zhvillohet në një prej hoteleve në qendër të Tiranës do të vijojë me një raport për bashkëqeverisjen si dhe me pas një raport për punën e grupit parlamentar.

Permbuesi Gjyqësor Privat Çezar Beja  
Administrative Manëz, Bashkia Durres  
Çmimi ne ankandin e dÿte eshte 2.534.400 leke  
2.Lloji i pronës: "ARE", Nr Pas 39/03, ZK 3137, Vol 5, Fq 62, Sip 2590m2, Adresa Rade, Njesia Administrative Manëz, Bashkia Durres  
Çmimi ne ankandin e dÿte eshte 4.316.400 leke  
Ankandi do te zhvillohet ne zyrën e permbuesit gjyqësor privat Çezar Beja ne datën 20.09.2018 duke u mbyllur ne oren 16.00

Shitje me Ankand te dÿte nga Studio Permbarimore L.D.C  
"Apartament", me sip. 69.2 m2, Nr pasurie 10/158+2-1, Z. K 8631, vol. 9, fq 80, me adrese Lagjia Skenderbeg, Shk. 2, Kati 1, Ap. 1, Lezhe. Prona eshte e regjistruar pranë Z.V.R.P.P Lezhe, ne emer te Lulzim Kros Beqiri. Çmimi i ri per shitje eshte 2.170.000 leke.  
Data e shpalljes 06.08.2018  
Data e zhvillimit 11.09.2018 deri ne oren 16.00  
Ankandi zhvillohet ne ambientet e Studios Permbarimore L.D.C me adrese Rruga "Myslym Shyri" Vila 8/1, kati 1 Tirane.



PD mbledh firmat, Basha prezanton nismën: S' do ketë kompromis me krimin

# 'Veting për politikanët'. PD shpall nismën për ndryshime kushtetuese

## Ligji prek deputetët dhe pushtetarët

Valentina Madani

Partia Demokratike zyrtarizoi dje nismën kushtetuese për vetingun në politikë si rruga drejt shkëputjes së pushtetit me krimin e organizuar. Nga Elbasani ku opozita e bashkuar u mbledh sërish dje, Lulzim Basha prezantoi katër objektivat e "platformës për çlirimin e qeverisë nga krimi". Basha tha se kërkesa e PD-së për veting në politikë po firmoset nga deputetët e PD-së. Sipas tij, vetingu në politikë është jetik për shkak të lidhjeve kriminale të qeverisë. Përmes kësaj nisme, Partia Demokratike synon që politikanët e inkriminuar të largohen nga politika. "Vendimi ynë është t'i japim fund një elite politike të lidhur me krimin dhe të çojmë politikanët e lidhur me krimin, në radhë të parë jashtë institucioneve dhe pastaj para një drejtësie të reformuar dhe jo para një drejtësie të kapur", tha Basha në fillim të mbledhjes së opozitës. PD beson se duhet zbatimi i vetingut dhe masa e kontrollit të figurës edhe për politikanët dhe zyrtarët e të tjerë të lartë publikë, pasi dekriminalizimi plotësisht qeverisjes dhe politikën, lufton me tolerancë zero korupsionin dhe krimin, ndalon aleancat mes politikanëve dhe grupeve kriminale, pastron nga radhët e politikanëve dhe zyrtarëve të lartë individë të korruptuar dhe të lidhur me krimin e organizuar. Garanton qeverisjeja pa ndikimin e kriminit të organizuar. "Rama është me krimin, ne jemi me njerëzit", theksoi kryedemokrati, i cili vuri në dukje vendosmërinë e opozitës për t'u kthyer qytetarëve mundësinë të vendosin vetë për fatin e tyre, për zgjedhjet e lira e të ndershme. Ligji i propozuar nga PD për realizimin e vetingut edhe ndaj deputetëve, kryeministrit, ministrave, kryetarëve të institucioneve kushtetuese është një mundësi reale për fillimin e ligimit të qeverisjes nga krimi.



Tryeza e djeshme e opozitës, dje në Elbasan

**AKUZA**

"Shqipëria po destabilizohet nga krimi, sepse krimi po sundon Shqipërinë. Kryeministri ua ka dorëzuar kontrollin e vendit kriminelëve e bashkëpunëtorëve të kriminit nga Fatmir Xhafaj, të Taulant Balla. Elbasani është edhe gjeneza e bashkëqeverisjes me krimin", theksoi z.Basha.

**LIGJI**

Ligji i propozuar nga Partia Demokratike për realizimin e vetingut edhe ndaj deputetëve, kryeministrit, ministrave, kryetarëve të bashkive dhe drejtuesve të institucioneve kushtetuese është një mundësi reale për fillimin e ligimit të qeverisjes nga krimi.

**PLATFORMA ANTIKRIM, KATËR OBJEKTIVAT E PLATFORMËS**

- 1 - Dekriminalizimi i plotë përmes vetingut të politikanëve të lidhur me krimin.
- 2 - Çlirimi i drejtësisë nga kapja politike në funksion të bashkëqeverisjes së Edi Ramës me krimin.
- 3 - Zgjedhje të lira të ndershme, demokratike ku qytetarët të jenë ata që vendosin.
- 4 - Një ekonomi e çliruar nga monopoli, nga oligarkët dhe nga korupsioni qeveritar, në funksion të mirëqenies së qytetarëve.

### Berisha publikon foton: Një prej të arrestuarve, mik me Veliajn

Ish-kryeministri Berisha deklaroi dje në Elbasan se fokusi i aksionit opozitar duhet të jetë kryeministri Edi Rama, pasi të tjerët janë dytësorë. "Të fokusohemi te Rama. Ai është kryesori. Të tjerët janë dytësorë", deklaroi z.Berisha. Po dje, Berisha publikoi foton e një prej katër të arrestuarve gjatë aksionit të policisë në Shkodër mbrëmjen e kaluar. Përmes një postimi në "Facebook", ish-kryeministri shprehet se njëri prej të arrestuarve është mik me kreun e Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj. "Erogen Brajoviq, i arrestuar dje në Shkodër, mik për kokë i Lal Plehut!", shkruan Berisha. Kujtojmë se në operacionin që u zhvillua dje në Shkodër u arrestuan 4 persona si të përfshirë në aktivitetet kriminale, mes tyre edhe i riu që ka dalë në foto me kreun e Bashkisë së Tiranës.

zbatimin e menjëhershëm, duke i hapur rrugë kështu procesit të vetingut për të gjithë politikanët në detyra shtetërore dhe zyrtarët e tjerë të lartë publikë", thuhet në njoftimin e PD-së.

**TAKIMI**

Opozita e bojkotoi edhe seancën e djeshme plenare duke organizuar një mbledhje në qytetin e Elbasanit, nga ku kryetari i PD, Lulzim Basha, e quajti si sim-

bolin e bashkëqeverisjes me krimin. Situata e kriminalitetit në disa qytete të vendit është edhe arsyeja e bojkotit nga ana e partive opozitare të Kuvendit. Ai shprehu shqetësimin se situata është shumë e rëndë, ndërsa opozita do të marrë vendime të rëndësishme. "Shqipëria po destabilizohet nga krimi, sepse krimi po sundon Shqipërinë. Kryeministri ua ka dorëzuar kontrollin e vendit

kriminelëve dhe bashkëpunëtorëve të kriminit nga Fatmir Xhafaj, të Taulant Balla. Elbasani është edhe gjeneza e bashkëqeverisjes me krimin. Xhrika, fabrika e kokainës, është çengeli kriminal që mban të varur Edi Ramën, përmes pjesëmarrjes së vëllait të kryeministrit Olsi Rama. Faktet e përfshirjes së tij janë fshehur nga Saimir Tahiri dhe vazhdojnë të mbetet të fshehura nga Xhafaj. Kjo është arsyeja pse sabotohet komisioni hetimor. Sepse faktet tronditëse që do të dalin nga hetimi parlamentar, që bashkëveprimi i Edi Ramës me krimin në Elbasan ngriti çengelin e kriminit nga ku varet tani e 5 vite më parë Edi Rama", u shpreh z.Basha. z.Basha komentoi edhe rezultatet e operacionit të Policisë në Shkodër. "E gjitha është shfaqje propagandistike. Kështu ishte në Elbasan para një viti. Asnjë prej Çapjave që goditën policinë nuk është ndjekur penalisht dhe të njëjtin fat do të ketë edhe operacioni propagandistik në Shkodër. Pasi propaganduan me makinat e blinduara të familjeve kriminale të Shkodrës, do presin skandalin e radhës dhe do lënë të qetë krimin", u shpreh kreu i opozitës.



**Bylykbashi:**  
Rama refuzon vetingun me ligj të politikanëve

Deputeti i PD-së, Oerd Bylykbashi zbardhi dje arsyet pse Edi Rama e kundërshton vetingun në politikë. "Rama kundërshton duke thënë që vetingun ta bëjë drejtësia "e reformuar" prej tij, propozon që vetingu i politikanëve të shtyhet sa më shumë në kohë nëpërmjet zvarritjes prej tij të reformës në drejtësi duke bllokuar ngritjen e KLGJ, KLP, Prokurorit të Përgjithshëm, SPAK dhe Byrosë Kombëtare të Hetimit. Rama kundërshton sepse ai e di që vetingu i politikës me ligjin që propozon opozita nuk ka nevojë të presë vetingun e gjyqtarëve dhe prokurorëve. Praktikisht, Rama refuzon që vetingu për lidhjet me krimin që po bëhet për 800 gjyqtarët dhe prokurorët të bëhet pa humbur kohë edhe për vetë atë, ministrat e tij, 140 deputetët, kryebashkiakët e vendit dhe këdo që ka fatet e shqiptarëve në dorë. "Refuzon, sepse e di shumë mirë që do e mbyse lumeni i zi i paktit të tij me krimin për të marrë dhe mbajtur pushtetin, llum që do ta nxjerrë në shesh ky veting dekriminalizues", tha z.Bylykbashi.



**Vasili:** Nuk ndalemi derisa Shqipëria të pastrohet nga krimi

Nga Elbasani, ku opozita u mbledh sërish dje, kryetari i grupit të LSI, Petrit Vasili bëri të qartë se marrëdhënia me parlamentin do të vazhdojë të jetë e njëjtë. Ai tha se opozita është pranë qytetarëve në Shkodër dhe Elbasan, të cilët ndjehen çdo ditë të kërcënuar nga krimi. "Kemi një strategji për të nxjerrë vendin nga krimi. Jemi pranë Elbasanit dhe Shkodrës, pranë qytetarëve, të cilët çdo ditë ndihen të kërcënuar. Marrëdhëniet tona me parlamentin do të vijojnë të njëjta", u shpreh Vasili. Zyrtari i lartë i LSI foli edhe për bojkotin e opozitës në Kuvend. "Në parlament kemi qenë vazhdimisht të pranishëm dhe në momente të caktuara kur ai kalbëzohet dhe qëndron larg popullit për t'u fshehur krimin, ne do të marrim atë që qytetarët thonë për t'ia përplasur në fytyrën demagogjisë, kalbësirës së pushtetit", theksoi z.Vasili.

## PARLAMENTI VENDIMET

Paloka iu drejtua Kuvendit me kërkesë. Braho, Braçe e Fino votuan kundër

# Mungon opozita, PS zgjat me 3 muaj komisionin hetimor 'Tahiri'

Shtyhen për mungesë votash Kodi Rrugor dhe statusi i gjyqtarëve

Darina Tanushi

Mazhoranca pranoi dje në mungesë të deputetëve të opozitës kërkesën e bërë një ditë më parë nga deputeti demokrat, Edi Paloka për shtyrjen e afatit të komisionit hetimor për ish-ministrin e Brendshëm, Saimir Tahiri. "Sot (dje) në mëngjes na ka ardhur një kërkesë nga kreu i komisionit hetimor parlamentar, zoti Paloka, që është bërë publik. Më lejoni që të njoh Kuvendin lidhur me ecurinë dhe për të arritur në vendimmarrjen e këtij komisioni", tha Ruçi. Më pas Kuvendi hodhi në votim kërkesën e PD-së për ta shtyrë edhe me 3 muaj të tjerë veprimtarinë e komisionit. Me 72 vota pro, 3 kundër dhe dy abstenim është miratuar zgjatja e hetimeve për komisionit hetimor parlamentar për Saimir Tahirin. Mësohet se votat kundër ishin nga Spartak Braho, Erjon Braçe dhe Bashkim Fino. Po kështu abstenuan 2 deputetë, Alket Hyseni dhe Elena Xhina. Komisioni hetimor për ish-ministrin e Brendshëm, Saimir Tahiri është ngritur në muajin mars 2018, pak javë para heqjes së mandatit. Ky komision ka kërkuar disa herë shtyrjen e afatit të hetimeve, ndërkohë që në kërkesën që Paloka i drejtoi Kuvendit të mërkurën, kërkohej që ministri i Brendshëm, Fatmir Xhafaj dhe drejtori i Përgjithshëm i Policisë, Ardi Veliu të japin dorëheqjen, pasi sipas PD-së, pengojnë hetimet. "Ministria e Brendshme dhe Policia e Shtetit nuk i kanë vënë në dispozicion për 5 muaj asnjë dokument komisionit hetimor. Ministri i Brendshëm dhe kreu i policisë akuzohen nga PD për pengim të qëllimshëm të komisionit hetimor 'Tahiri'. Pengimi i komisionit ka qëllim fshehjen e gjurmëve të lidhjeve të qeverisë me krimin e organizuar", - thuhej në kërkesën e PD-së. Në rendin e ditës së seancës plenare ishin parashikuar për votim edhe projektligjet e mbartura nga seancat plenare të sesionit të shkuar



Komisioni hetimor për ish-ministrin e Brendshëm, Saimir Tahiri

parlamentar: projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" dhe projektligji "Për një ndryshim dhe shtesë në ligjin nr. 8378, datë 22.7.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar". Për shkak të mosplotësimit të kuorumit të deputetëve

pjesëmarrës, duke qenë se miratimi i këtyre projektligjeve kërkonte shumicë të cilësuar, votimi u shty për në seancën e radhës. Në drejtimin e kryetarit të Kuvendit, z.Gramoz Ruçi, Kuvendi miratoi në seancën e sotme plenare aktin normativ nr. 1, datë 26.7.2018, "Për disa ndryshime në ligjin nr. 109/2017, "Për buxhetin e vitit 2018".

### Krimet e Rënda zgjatim hetimet për dy drejtuesit e dyshuar për lidhje me Habilaj

Prokuroria e Krimeve të Rënda zgjat hetimet për dy nga tre drejtuesit e lartë të Policisë së Shtetit, Jaeld Çelës dhe ish-drejtorin e policisë së Vlorës, Gjergji Kohilës, të dyshuar për përfshirje në trafikun ndërkombëtar të lëndëve narkotike në mbështetje të grupit të organizuar kriminal të vëllezërve Habilaj. Hetimet do të zgjatën nga data 20.8.2018 deri më 20.11.2018. Ndonëse hetimet zgjatën për Celën e Kohilën, së bashku me ish-kreu i policisë kufitare të Dhërmiut, Sokol Boden ata akuzohen për përfshirje në trafikun ndërkombëtar të lëndëve narkotike në mbështetje të grupit të organizuar kriminal të vëllezërve Habilaj. Mbi ta rëndon po ashtu akuzat e shpërdorimit të detyrës. Operacioni për arrestimin e tyre u dekonspirua, ndërsa që prej janarit 2018 të tre ish-zyrtarët e policisë qëndrojnë në arrat.



### Kryeministri në Elbasan, prit me protesta nga PD

## Rama: Këtë vit nis shkolla e drejtorëve, kemi hequr 300

Kryeministri Edi Rama u prit dje në Elbasan me protesta nga opozita, ndërsa priste të takojë me mësuesit ndihmës të fëmijëve me nevoja të veçanta, në prag të fillimit të vitit të ri shkollor 2018-2019. Disa qytetarë dhe deputetë të PD-së të mbledhur para ambientit ku po zhvillohej takimi, e kanë pritur me parulla dhe thirrje kreun e qeverisë, duke thënë se ai po mashtron prindërit dhe fëmijët me librat falas. Protesta u zhvillua para gjimnazit "Dhaskan Todri", pak larg vendit ku Rama do zhvillonte takimin me mësuesit. I pranishëm në vendin e protestës ishte edhe Drejtori i Policisë së Elbasanit, Altin Qato, i cili është akuzuar nga protestuesit. Sipas tyre, ai ka shkelur rregullat pasi nuk lejohet policë me armë në rresht të parë. Kryeministri Edi Rama i shoqëruar nga ministria e Arsimit, Lindita Nikolla, foli në këtë takim me mësuesit në Elbasan për reformën në arsim dhe për 700 mësuesit ndihmës që do të jenë për fëmijët me nevoja të veçanta. Mirëpo në fjalën e tij para mësuesve, kryeministri nuk ka "harruar" të thumbojë protestuesit që ishin mbledhur për vizitën e tij. Ai tha se këtë vit do të nisë edhe shkolla e drejtorëve. "Drejtorët e shkollave do kanë një shkollë të tyre. Nuk mundet dot të vazhdojmë të synojmë me shumë nëse kemi këtë nivel drejtimi të shkollave. Kemi hequr 300 drejtorë shkollash, jo për politikë dhe nuk i kemi zëvendësuar me politikë. I kemi zëvendësuar duke u kërkuar të bëhen drejtorë 300 mësuesit më të mirë në bazë të pikëve që kanë marrë, por nuk mjafton", u shpreh Rama.

### Kreu i Kuvendit takon reporterët e Asamblesë së Këshillit të Evropës

## Ruçi: Opozita nuk ka arsye të kërkojë kthimin pas të reformës në drejtësi

Kryetari i Kuvendit, Gramoz Ruçi u takua dje me reporterët e Komitetit Monitorues të AP të Këshillit të Evropës, Andrej Hunko, përfaqësues i Bundestagut gjerman dhe Joseph O'Reilly, senator i Dhomës së Lartë të Irlandës, të cilët ndodhën në Shqipëri për një vizitë faktmbledhëse për monitorimin e detyrimeve dhe angazhimeve të Shqipërisë. Gjatë takimit u diskutua mbi zbatimin

nga Shqipëria të standardeve të Këshillit të Evropës, për zhvillimet e fundit politike, prioritetet e qeverisjes, ecurinë e zbatimit të reformave, luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar dhe çështje të tjera me interes të përbashkët. "Reforma zgjedhore është prioriteti i të gjitha forcave politike. Për këtë, Shqipëria do të vazhdojë bashkëpunimin e ngushtë dhe të suksesshëm me OSBE/ODIHR, duke syn-

uar zhvillimin e zgjedhjeve të lira dhe të ndershme, sipas standardeve më të mira ndërkombëtare. Komisioni i reformës pritet të përfundojë punën e tij deri në fund të këtij viti", - u shpreh Ruçi. Duke folur për reformën në drejtësi, Ruçi theksoi se ajo është shtylla tjetër e rëndësishme. "Opozita nuk ka arsye të kërkojë kthimin prapa të kësaj reforme, duke sulmuar organet e vetëgjyqësorisë dhe të drejtësisë, sepse reforma mbështetet mbi urtinë dhe dëshirën e



madhe të shqiptarëve për drejtësi. Reforma është krejtësisht jashtë ndikimit të sistemit", - tha ai. "Praktikisht të qeverisë dhe të shumicës parlamentare dhe nën monitorimin e rreptë dhe të plotë të ONM. Kjo është theksuar edhe në Kushtetutë dhe është dispozita e vetme kush-

tetuese në botë, që pranon një trupë të huaj mbikëqyrëse të sistemit", - tha ai. "Praktikisht për vetëgjyqësorin nënvizoi Ruçi - unë nuk di asgjë, ndërsa ONM di gjithçka". "Ethet e pushtetit nuk duhet të na bëjnë të sabotojmë ndërtimin e shtetit", - tha ai.

Mesazhi për 14-vjetorin e LSI: Jemi parti e mundësive dhe e integritimit evropian

# Kryemadhi: I frytshëm bashkëpunimi me Berishën, Rama ngre kurthe

*"PS parti arrogante, e mbushi vendin me drogë"*

Valentina Madani

**K**ryetarja e Lëvizjes Socialiste për Integritim, Monika Kryemadhi, ndau dje urimin e saj me të gjithë anëtarët dhe simpatizantët e LSI-së, në përvjetorin e 14-të të kësaj partie. Në mesazhin e saj, Kryemadhi thekson se LSI lindi si një parti e shpresës dhe e integritimit evropian. Por në 14-vjetorin e LSI, kryetarja e saj shkruan në "Facebook" për historikun e rrugëtimit të kësaj force, raportet me partitë e tjera, pushtetin dhe aktualitetin. "Ne u rënjosëm menjëherë në popull dhe te njerëzit, pranë të përditshmes së tyre, pranë punës dhe shkollës. U lindëm si një forcë progresiste, për më shumë barazi ndërmjet shtresave të popullit, për më shumë shanse të barabarta në çdo qelizë të shoqërisë sonë, që rrezikohej dhe rrezikohet edhe sot të përçahet, në oligarkë dhe shërbëtorët e tyre harbutë dhe në mjernanë, që kanë humbur shpresat në vendin e tyre", shprehet zj. Kryemadhi. Ajo vlerëson bashkëpunimin me Sali Berishën, teksa shprehet se Rama ngriti vetëm kurthe. "Në vitin 2009 ne bashkëpunuam në qeverisje me PD-në, pavarësisht ndryshimeve ideologjike, për të nxjer-



Kryetarja e Lëvizjes Socialiste për Integritim, Monika Kryemadhi

rë Shqipërinë nga kaosi i zgjedhjeve të njëpasnjëshme politike, në një klimë të tensionuar dhe tejet të ashpër. Sepse vendi kishte si përparësi liberalizimin e vizave dhe ishte tashmë prej pak muajsh, anëtar i NATO-s. Ne shqiptarët duhet të dilnim nga getoja e radhëve të gjata e jo rrallëherë korruptive në dyert e ambasadave për të mar-

rë një vizë. Një bashkëpunim dhe një bashkëqeverisje, që do ta vlerësoja në vija të përgjithshme si të frytshëm, në reforma, në luftën kundër krimit të organizuar, në liberalizimin e vizave dhe në konsolidimin e detyrave të shtruara pas anëtarësimit në NATO", shprehet Kryemadhi. "Por - shtoi ajo - nëse ne bashkëpunuam frytshëm

me ish-kryeministrin Berisha, nuk mund të them se arritëm rezultate të ngjashme pozitive me Rilindjen e Edi Ramës, që ishte një farsë, një fasadë dhe një maskë për nënshtruar Partinë Socialiste dhe pastaj të gjithë shqiptarët". Kryemadhi vuri në dukje se: "Me PS-në ishim më afër ideologjikisht, por përse ta fshehim, kishim edhe nostalgjinë e kohës si ish-socialistë e themelues të dikurshëm, që në orët e para të lindjes së kësaj partie. Por PS-ja nën drejtimin e Ramës dhe të rilindasve, u bë edhe më arrogante dhe në vend që të qeveriste, e mbushi vendin me drogë dhe vazhdimisht ideoi e organizoi vetëm kurthe, intriga dhe fushata të maskuara mediatike kundër LSI-së. Të gjithë ne, sot jemi të qartë që kemi

përballë jo vetëm një qeverisje të dështuar, por edhe një regjim të mirëfilltë, që mbahet në këmbë nga bandat e drogës, nga bandat që vrasin dhe terrorizojnë qytetet shqiptare, në Shkodër, Elbasan, Vlorë, Durrës, Fier dhe padyshim edhe në Tiranë, nga bandat e tenderaxhinjve, nga bandat e mediave të shitura. Por, ne kemi lindur dhe do të vijojmë të jemi një parti njerëzish guximtarë e trima, djem e vajza që kanë pasion dhe mision sfidën dhe që nuk u trembën nga bandat e mercenarëve. Sepse kështu ka qenë dhe do të jetë: "Nuk ka më frikacakë më të mëdhenj se sa mercenarët kur ndeshen me idealistët dhe nuk ka më trima në botë se sa misionarët që kanë qëllim çlirimi", theksoi kryetarja e LSI.

**ALEANCAT**

"Nëse ne bashkëpunuam frytshëm me ish-kryeministrin Berisha, nuk mund të them se arritëm rezultate të ngjashme pozitive, me Rilindjen e Edi Ramës, që ishte një farsë, një fasadë dhe një maskë, për nënshtruar PS-në dhe pastaj të gjithë shqiptarët", tha Kryemadhi.

**Universiteti Europian i Tiranës**  
maiora premtur / gjëra të mëdha na presin

**TRANSFEROHU NË UET**  
MUNDËSIA E DYTË PËR NJË EDUKIM GILËSOR

**DATA 03-13 Shtator 2018**

- Juridik i Përgjithshëm
- Financë & Bankë
- Menaxhim Biznesi
- Informatikë Ekonomike
- Shkenca Politike
- Marrëdhënie Ndërkombëtare
- Psikologji
- Sociologji – Antropologji Sociale
- Komunikim – Marrëdhënie Publike
- Komunikim Dizajn

Rënia e lindjeve me 25 %, qeveria plan masash kundër plakjes së popullsisë

# Ahmetaj: Pagesë për çiftet e reja për të rritur lindshmërinë

*Paketa e solidaritetit, sa do të përfitojnë pensionistët*

Qeveria shqiptare do të hartojë një paketë të mirëfilltë ndihme për çiftet e reja me qëllim rritjen e lindshmërisë në vend. Lajmi është bërë i ditur dje nga ministri i Financave dhe Ekonomisë, Arben Ahmetaj, gjatë seancës parlamentare ku ka prezantuar edhe aktin normativ, i cili sjell ndryshime në buxhetin e vitit 2018. Duke u nisur nga të dhënat e Institutit të Statistikave, në tremujorin e dytë të vitit, numri i lindjeve pësoi rënie drastike me 25%, qeveria do të hartojë politika të posaçme mbështetëse për çiftet e reja. Ndërkaq, rritja e pagës reale është një tjetër sfidë e qeverisë në vitet në vijim, ministri Ahmetaj theksoi se papunësia dhe pagat e ulëta vijojnë të jenë një problematikë e vazhdueshme. Sipas tij, në këtë drejtim qeveria do të nisë një reformë të thellë ku të gjithë punëkërkuessit e papunë dhe ata që marrin ndihmë ekonomike, do t'i nënshtrohen rikualifikimit. Ministri i Financave foli edhe për prirshmëritë për rritjen ekonomike, investimet e huaja si dhe paketën e solidaritetit prej rreth 3 miliardë lekësh, e cila siguron shpërblimin e fundvitit për pensionistët në vlerën e 5 mijë lekëve.

## PAKETA E SOLIDARITETIT

"Kemi bërë debat se sa i kemi mbështetur pensionistët dhe familjet në nevojë, me atë që ne i referohemi "Paketa e solidaritetit". Po ta shikoni, kam bërë një krahasim mes qeverisjes 8-vjeçare të PD-së dhe 4-vjeçare të PS-së. Totali në 8 vite i qeverisë së Partisë Demokratike ka qenë 10.5 miliardë dhe po ta shikoni profilin e dhënies së bonusit gjatë qeverisjes së tyre, është 1 herë në 2 vite gjatë viteve elektorale. Ndërsa, po ta shikoni atë që kemi bërë në 4 vite, është 11.3 miliardë. Pra, në 4 vite ne kemi dhënë gati 10 % më shumë se ç'kanë dhënë qeveria e PD-së në 8 vite dhe mënyra e ofrimit të paketës së solidaritetit nga ana jonë nuk ka lidhje fare me vitet elektorale. Shihni kohën kur ne japim bonus, pa dallim, dhe kohën kur ata tentojnë të japin bonuse vetëm në vite elektorale"-tha ministri i Financave Arben Ahmetaj.

## SITUATA EKONOMIKE

Ministri i Financave bën të ditur se Prodhimi i



Ministri i Financave dhe Ekonomisë, Arben Ahmetaj

Brendshëm Bruto (PBB) u rrit me 4.45 % në terma real në tremujorin e parë të vitit 2018 dhe të gjitha të dhënat indirekte tregojnë që do të

kemi po një rritje të këtij niveli në tremujorin e dytë. "Ndërkohë që objektivi ynë vazhdon të qëndrojë një rritje 4% - 4.2% në fund të

vitit 2018, dhe në referencë të planifikimeve që institucionet ndërkombëtare me gjithë qëndrimin konservator në përgjithësi të tyre, ref

### RIALOKIME BRENDA ZËRAVE TË BUXHETIT

- Miratimin e një fondi në masën 3 miliardë lekë për shpërblimin e pensionistëve (rreth 5.000 lekë/pensionist), për t'u akorduar në fund të vitit, që është rezultat i kursimeve nga skema e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, si dhe parashikimit të rritjes së të ardhurave nga kontributet në këto skema.
- Miratimin e një bonusi rreth 300 milionë lekë për kategoritë në nevojë, pra që shkon gjithë paketa e solidaritetit në 3.3 miliardë.
- Rialokimi i shpenzimeve kapitale, ku kryefjala është rialokimi nga projektet me ecuri të ngadaltë.
- Mbështetje sektorit energjitik përmes rritjes me 1.5 miliardë lekë të tavanit të financimit të huaj, tashmë të konsumuar.
- Së fundi, është mbështetur me 1 miliard lekë financimi i plotë për projektet në vazhdim dhe hapja e disa projekteve të reja prioritare me financim të brendshëm.

erojnë për ekonominë shqiptare. Komponentët e shpenzimeve, të cilët gjeneruan pjesën më të madhe të rritjes ekonomike në tremujorin e parë të vitit 2018, ishin konsumi dhe investimet, pra konsumi i bazuar kryesisht tek kërkesa e brendshme. Përkatesisht, konsumi total u rrit me rreth 2.96%, gati 3% në terma real, po aq edhe ai i privat i familjeve, që tre-

gon për disa tremujorë rresht, rritje të konsoliduar të konsumit, i bazuar në kërkesën e brendshme dhe në përmirësimin, pra në konsengucencë dhe për shkak, të përmirësimit të konsiderueshëm të tregut të punës. Ndërsa investimet totale gjatë tremujorit të parë të vitit 2018 u rritën me rreth 5.43% në terma real"-bën të ditur Ahmetaj.



## Vendimi i Këshillit Mbikëqyrës

### Së shpejti emetohet prerja 10 000 lekë

U miratua tematika dhe lista e elementeve të sigurisë për kartëmonedhën shqiptare me kurs ligjor, prerja 10,000 lekë. Këshilli i Mbikëqyrës analizoi gjatë mbledhjes së djeshme se në gjashtëmujorin e parë të vitit 2018, veprimtaria e sektorit bankar u paraqit e qëndrueshme, me tregues të mirë të performancës dhe të rezistencës financiare. Por sipas analizës së Bankës qendrore sektori u karakterizua nga rënia e aktiveve në valutë për shkak të mbicimit të ndjeshëm të kursit të këmbimit të lekut, i cili ndikoi në tkurrjen vlerës së totalit të aktiveve të sektorit për periudhën në fjalë. Këshilli, gjithashtu, miratoi Deklaratën dhe Raportin e Stabilitetit Financiar për gjashtëmujorin e parë të vitit 2018. Këshilli vlerësoi se zhvillimet ekonomike dhe ecuria e tregjeve financiare mbështetën në tërësi veprimtarinë e sistemit financiar. Gjatë periudhës, ekspozimi i sektorit bankar ndaj rreziqeve të veprimtarisë nuk pati ndryshime të ndjeshme dhe se aftësia e sektorit bankar për të përballuar këto rreziqe, në kushtet e niveleve të larta të likuiditetit, kapitalizimit dhe përfutueshmërisë, vlerësohet e fortë.


**ANALIZA**  
Këshilli i Mbikëqyrës analizoi gjatë mbledhjes së djeshme se në gjashtëmujorin e parë të vitit 2018, veprimtaria e sektorit bankar u paraqit e qëndrueshme, me tregues të mirë të performancës dhe të rezistencës financiare.

## Agjencia e Legalizimeve bën bilancin 5-vjeçar

### ALUIZNI shpërndan 47 mijë leje legalizimi në kryeqytet

Në Qarkun Tiranë ndodhet numri më i madh i aplikimeve si dhe i zonave informale në vend, 58 të tilla, si në, Tiranë, Kamëz, Bathore, Farkë, Selitë, Dajt, Paskuqan, Kashar, Ndroq, Bërçull, Vorë, Kavajë, Synej. Viti me më pak legalizime është viti 2010 me 276 legalizime, ndërsa ai me rekordin më të lartë është viti 2016 ku janë kryer 17 672 legalizime. Po ashtu, pranë zyrave të ALUIZNI-t janë paraqitur rreth 2000 kërkesë/ankesa, të cilat janë shqyrtuar në mënyrë korrekte duke garantuar ofrimin e një shërbimi cilësor dhe mirëinformues për zgjidhje konkrete.

Gjatë punës në këto 5 vite ALUIZNI gjeti zgjidhje ligjore për disa çështje me ndikim në interesin e qytetarëve, grupeve apo kategorive të caktuara, e më konkretisht: janë legalizuar në emër të banorëve, 14 pallatet e shoqërisë "Hawai" sh.p.k. administratori i të cilëve kishte shpallur falimentin. I dhëmë udhëzgjdhjes së shqetësimit të 400 familjeve të shpërngulura nga ndërtimi i njësjellsit të Bovillës.



## STATISTIKAT

Viti me më pak legalizime është viti 2010 me 276 legalizime, ndërsa ai me rekordin më të lartë është viti 2016 ku janë kryer 17 672 legalizime. Po ashtu, pranë zyrave të ALUIZNI-t janë paraqitur rreth 2000 kërkesë/ankesa, të cilat janë shqyrtuar në mënyrë korrekte duke garantuar ofrimin e një shërbimi cilësor dhe mirëinformues për zgjidhje konkrete.

Kemi pajisur me leje legalizimi banorët e pallateve të ngritura nga firmat investitore, të cilët kanë braktisur procesin e legalizimit apo kanë falimentuar, si dhe është dërguar pranë Bashkisë

Tiranë lista e subjekteve që nuk u janë përgjigjur të legalizimit të ndërtimeve të tyre. E gjetëm Qarkun e Tiranës me 6 466 legalizime dhe sot jemi me shifrën e 47 053 legalizime të kryera.



Trashëgimtarët duhet të plotësojnë dokumentet në Drejtorinë e Pagesave

Ornela Manjani

Ish-të përndjekurit, 200 përfituesit e kështit të dytë

Afati për plotësimin e dosjes, 3 muaj

Rreth 200 trashëgimtarë të ish-të dënuarve politikë që presin të marrin kështin e dytë duhet të plotësojnë dokumentacionin që u mungon në dosje për të marrë më pas paratë. Lista është bërë publike dhe nga Ministria e Financave...

ë ish-të dënuarve duhet të sigurohen pranë bankës në të cilën kanë hapur llogarinë që llogaria e tyre është aktive. Në rast se llogaria nuk është aktive, shuma e dëmshpërblimit kthehet mbrapsht në buxhet duke sjellë vonesa dhe ndërlikime...

të panevojshme. Kur kemi ndryshim të identitetit, Emër/Mbiemër, apo në rastet kur në certifikatë ndryshon emri ose mbiemri, qoftë edhe me një gërmë të vetme në krahasim me dëshminë e trashëgimisë apo prokurës, kartës së identitetit dhe çdo...

dokumenti tjetër të nevojshëm, duhet medoemos që në të gjitha dokumentet emrat të jenë të njëjtë me atë që është shkruar në certifikatën e lëshuar nga gjendja civile. Në rast se ka transkriptime të gabuara gjatë kohës nga një certifikatë e...

një periudhe të caktuar, atëherë këto ndryshime duhet të pasqyrohen brenda formatit të certifikatës apo edhe të një vërtetimi të veçantë të lëshuar nga zyra e gjendjes civile. Ligji parashikon edhe rastet e ekzekutimeve pa gjyq. "Në...

rastet e ekzekutimeve kapitale pa gjyq, është i domosdoshëm një vendim fakti gjykatë që vërteton vdekjen, plus një certifikatë negative të lëshuar nga zyra e gjendjes civile. Në rastet kur për arsye të njohura në gjendjen civile nuk ekzistojnë dokumente të periudhës përkatëse dhe ky fakt vërtetohet nga gjendja civile, i interesuari është i detyruar të bëjë një gjyq fakti, të cilin edhe në këtë rast si në pikën më lart, duhet ta shoqërojë me një certifikatë negative", thuhet në njoftimin që Ministria e Financave bën për të sqaruar trashëgimtarët e ish-të dënuarve që nuk kanë marrë...

DOKUMENTET Të gjithë trashëgimtarët

PËRFITUESIT E KËSHIT TË DYTË

Table with columns: EMER, MBIEMER, EMER, MBIEMER, EMER, MBIEMER, JETË LEJTE R/SH, PERS ONAL, KATE VOR, F/ KATE VOR, TIF/ KATE VOR, DESH TRASH, PRO- KUR E.

Table with columns: EMER, MBIEMER, EMER, MBIEMER, EMER, MBIEMER, JETË LEJTE R/SH, PERS ONAL, KATE VOR, F/ KATE VOR, TIF/ KATE VOR, DESH TRASH, PRO- KUR E.

Table with columns: EMER, MBIEMER, EMER, MBIEMER, EMER, MBIEMER, JETË LEJTE R/SH, PERS ONAL, KATE VOR, F/ KATE VOR, TIF/ KATE VOR, DESH TRASH, PRO- KUR E.

# STUDIMET NE ITALI KRITERET

Ja kush mund të aplikojë. Dokumentacioni që duhet të dorëzoni brenda 26 tetorit

## Bursa në Itali për studentët e Universitetit të Tiranës

Njihuni me 20 degët ku mund të kandidoni

Voltiza Duro

Studentët e Universitetit të Tiranës, tash më kanë mundësinë që të aplikojnë për bursa brenda datës 26 tetor të këtij viti në Bolonja të Italisë. Në faqen zyrtare të UT-së bëhet me dije se këto bursa studimi janë të vlefshme për semestrin e dytë të vitit akademik 2018-2019 e do të zgjasin 6 muaj, si për nivelin Bachelor ashtu edhe për Masterin. Të gjithë studentët e interesuar mund të aplikojnë për degë studimi si: Histori dhe Arkeologji; Filozofi dhe Etikë; Gjuhë e Huaj; Ekonomiks; Shkenca Politike; Psikologji; Sociologji; Gazetari; Kontabilitet; Financë-Bankë; Marketing; Administrim Biznes; Punë Sociale; Drejtësi; Biologji; Biokimi; Kimi; Fizikë; Matematikë; si dhe Statistikë. Këto bursa studimi mbulojnë kompensimin prej 850 euro në muaj për studentët si dhe kostot e udhëtimit, kjo në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës. "Studentët që përfitojnë nga mobiliteti nuk do të paguajnë asnjë tarifë për shkollim në universitetin pritës. Studentët do të vazhdojnë të paguajnë shkollimin e tyre dhe/ose tarifën e regjistrimit në universitetin e tyre të origjinës", theksohet në njoftimin e Universitetit të Tiranës.

### APLIKIMI NË BACHELOR

Studentët e nivelit Bachelor që janë të interesuar të fitojnë bursën 6 mujore në Universitetin e Bolonjës, duhet të paraqesin dokumentacionin përkatës gjatë aplikimit. Respektivisht, ata duhet të dorëzojnë një CV në gjuhën angleze apo italiane; një kopje e Pasaportës; vërtetim studentit si dhe një listë notash. Gjithashtu, kandidatët duhet të dorëzojnë edhe një letër motivimi në gjuhën angleze apo italiane në varësi të programit të studimit; certifikatën e gjuhës së huaj (Anglisht B1/Italisht B2 në varësi të programit të studimit); si dhe të ashtuquajturën "Learning Agreement". "Learning Agreement është një kontratë mi-



850

### EURO NË MUAJ

Këto bursa studimi mbulojnë kompensimin prej 850 euro në muaj për studentët si dhe kostot e udhëtimit, kjo në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës. Studentët që përfitojnë nga mobiliteti nuk do të paguajnë asnjë tarifë për shkollim në universitetin pritës.

26

### TETOR

Afati i fundit Studentët e Universitetit të Tiranës, tashmë kanë mundësinë që të aplikojnë për bursa brenda datës 26 tetor të këtij viti në Bolonja të Italisë. Në faqen zyrtare të UT-së bëhet me dije se këto bursa studimi janë të vlefshme për semestrin e dytë të vitit akademik 2018-2019 e do të zgjasin 6 muaj, si për nivelin Bachelor ashtu edhe për Masterin.

dis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvillohen në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë "Mobility Plan". Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe

kreditet që do të merrni në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihet në Universitetin e Tiranës kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit", citohet në njo-

ftim. Studentët duhet të kenë kujdes që gjatë aplikimit në Bolonjë, të përzgjedhin lëndë të njëjta me ato që do të kryenin në semestrin e parë në fakultetin e Universitetit të Tiranës, në mënyrë që lëndët

dhe kreditet të njihen kur të kthehen. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ato që studentët do të zhvillojnë në UT gjatë semestrit të parë, atëherë kur të kthehen sërish, studentët duhet të frekuentojnë që

### FUSHAT E STUDIMIT:

- Histori dhe Arkeologji;
- Filozofi dhe Etikë;
- Gjuhë e Huaj;
- Ekonomiks;
- Shkenca Politike;
- Psikologji;
- Sociologji;
- Gazetari;
- Kontabilitet;
- Financë-Bankë;
- Marketing;
- Administrim Biznes;
- Punë Sociale;
- Drejtësi;
- Biologji;
- Biokimi;
- Kimi;
- Fizikë;
- Matematikë;
- Statistikë;

### DOKUMENTACIONI

Dokumentet e nevojshme për aplikim për studentët e nivelit Bachelor:

- CV (në gjuhën angleze/italiane);
  - Kopje e Pasaportës;
  - Vërtetim studentit (e përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze/italiane në varësi të programit të studimit);
  - Listë notash (e përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze/italiane në varësi të programit të studimit);
  - Letër Motivimi në gjuhën angleze/italiane në varësi të programit të studimit;
  - Certifikatë e gjuhës së huaj (Anglisht B1/Italisht B2 në varësi të programit të studimit);
  - Learning Agreement;
- Dokumentet e nevojshme për aplikim për studentët e nivelit Master:
- CV (në gjuhën angleze/italiane);
  - Kopje e Pasaportës;
  - Vërtetim studentit (e përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze/italiane në varësi të programit të studimit);
  - Diplomë e nivelit Bachelor;
  - Listë notash e nivelit Bachelor (e përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze/italiane në varësi të programit të studimit);
  - Listë notash e nivelit Master (e përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze/italiane në varësi të programit të studimit);
  - Letër Motivimi në gjuhën angleze/italiane në varësi të programit të studimit;
  - Certifikatë e gjuhës së huaj (Anglisht B1/Italisht B2 në varësi të programit të studimit );
  - Learning Agreement;

nuk përshatën në Universitetin e Tiranës.

### APLIKIMI NË MASTER

Nërkohë, të gjithë studentët që vazhdojnë studimet master e dëshirojnë që semestrin e dytë të vitit akademik 2018-2019 ta kryejnë në universitetin e Bolonjës në Itali, duhet të paraqesin dokumentacionin brenda afateve të përcaktuara. Kështu, kandidatët duhet të dorëzojnë një CV në gjuhën angleze apo italiane; një kopje të Pasaportës; vërtetim studentit; diplomën e nivelit Bachelor ku duhet ti bashkëngjitet lista e notave. Gjithashtu, aplikanti duhet të dorëzojë edhe një listë notash të nivelit master të përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze apo italiane në varësi të programit të studimit si dhe një letër motivimi me një certifikatë të gjuhës së huaj. Ashtu si në nivelin bachelor, studentët duhet të paraqesin kontratën "Learning Agreement". Të interesuarit duhet të dorëzojnë dokumentacionin e mësipërm, dorazi në Rektoratin e Universitetit të Tiranës, pranë Drejtorisë së Komunikimit, Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë si dhe t'i dërgojnë të skanuara po të njëjtin dokumentacion në e-mailin iro@unitir.edu.al.

**STRATI** Shoqëria përbarimore "STRATI BAIIFFS SERVICE" Sh.p.k., njofton shpalljen për shitjen në ankand të pasurive të paluajtshme:

"Apartment", me Nr. 11733-1-22 pasurisë, me sipërfaqe 73 m<sup>2</sup>, Zona Kadastrale 8603, volumni 36, faqe 92, regjistruar në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Wore në pronësi të Shoqërisë "Elvi Konstruksion" Sh.p.k. Çmimi fillestar i ankandit është 20.440 Euro.

"Apartment", me Nr. 11733-1-23 pasurisë, me sipërfaqe 73 m<sup>2</sup>, Zona Kadastrale 8603, volumni 36, faqe 92, regjistruar në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Wore në pronësi të Shoqërisë "Elvi Konstruksion" Sh.p.k. Çmimi fillestar i ankandit është 20.440 Euro.

"Njësi", me Nr. 11733-1-11 pasurisë, me sipërfaqe 26 m<sup>2</sup>, Zona Kadastrale 8603, volumni 36, faqe 63, regjistruar në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Wore në pronësi të Shoqërisë "Elvi Konstruksion" Sh.p.k. Çmimi fillestar i ankandit është 14.560 Euro.

Ankandi për pasuritë e mësipërme zhvillohet në datë 13.09.2018.

Ankandi për pasuritë e mësipërme zhvillohet në ora 16.00, në ambientin e Shoqërisë përbarimore "Strati Baiff's Service", Rruga "Jordan Misja", Pall. 14/17, Shkalla 1, Ap. 7, Tiranë, Tel: 04 45 00 450, www.stratibaiff.com, info@stratibaiff.com

**SHPALLJE ANKANDI**

Zyra Përbarimore "E.G Baiff Service" me përbarues Enuar Merko me adresë Rr Ibrahim Rruova, Pall 64, Hyrja 8, Ap 1, Tiranë, njofton se me datë 01.10.2018 ora 8<sup>00</sup> - 16<sup>00</sup> në ambientet e saj, do të zhvillohet: Ankandi i III për shitjen e pasurive të paluajtshme. Tërthi me sipërfaqe totale 500 m<sup>2</sup> nga e cila Ndërtësi me sipërfaqe 128 m<sup>2</sup>, regjistruar në Z.V.R.P.P Durrës me Nr pasurie 72/67, Vol.3, Fq.189, ZK.1242 në pronësi të Z.Sali Ibrahim Jamaku me vlerë fillestare në ankand 81.043 (Tetëdhjetë e një mijë e dyzet e tre) EURO .

Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672027580, 355 4 22 31 888. email enuar.merko@gmail.com

**SHPALLJE ANKANDI**

Zyra Përbarimore "E.G Baiff Service" me përbarues Enuar Merko me adresë Rr Ibrahim Rruova, Pall 64, Hyrja 8, Ap 1, Tiranë, njofton se me datë 02.10.2018 ora 8<sup>00</sup> - 16<sup>00</sup> në ambientet e saj, do të zhvillohet: Ankandi i I për shitjen e pasurive të paluajtshme. Arë me sipërfaqe totale 1500 m<sup>2</sup> me numër pasurie 6/30, volumni 9 - faqe 174, zona kadastrale 1879 e ndodhur në Grykë Lumi, Lezhë në pronësi të Z.Gjon Zef Gjoka me vlerë fillestare në ankand 25.200 (Njëzet e pesë mijë e dyqind) EURO .

Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672027580, 355 4 22 31 888. email enuar.merko@gmail.com

**Kryebashkiaku: Bashkëpunim intensiv në transport**

**10- vjetori i binjakëzimit Tiranë - Pekin, Veliaj pret delegacionin kinez**

Në 10-vjetorin e binjakëzimit mes dy kryeqyteteve, Tirana dhe Pekini do të thellojnë bashkëpunimin në fushën e transportit, investimeve, kulturës dhe turizmit. Kryetari i Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj priti në një takim të veçantë një delegacion të lartë kinez, të kryesuar nga Nënkrjetarja e Komitetit të Përherëshëm të Asamblesë Popullore të Bashkisë Pekin, Yan Aoshuang, në të cilin u ra dakord për forcimin e mëtejshëm të marrëdhënieve me sdy qyteteve në disa sektorë të rëndësishëm. "Kjo është një marrëdhënie që ka nisur 10 vite më parë, kur Edi Rama dhe krye-

**POLITIKA**  
Kryetari i Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj priti në një takim të veçantë një delegacion të lartë kinez, të kryesuar nga nënkrjetarja e Komitetit të Përherëshëm të Asamblesë Popullore të Bashkisë Pekin, Yan Aoshuang, në të cilin u ra dakord për forcimin e mëtejshëm të marrëdhënieve me sdy qyteteve në disa sektorë të rëndësishëm.

tari i Bashkisë së Pekinit bënë binjakëzimin midis dy qyteteve. Ka qenë një marrëdhënie e shkëlqyer në këtë dekadë të parë dhe mezi presim të nisim një bashkëpunim edhe më intensiv me Pekinin në fushën e transportit, investimeve

dhe në fushën e kulturës dhe turizmit, sepse i shohim si baza të një marrëdhënie të shëndoshtë për ta çuar më tej binjakëzimin tonë", tha Veliaj, teksa në shenjë miqësie, i dorëzoi nënkrjetarjes së Komitetit të Përherëshëm të Asamblesë Popullore të

Bashkisë Pekin, Yan Aoshuang, edhe "Çelësin e Qytetit". Tirana është përzgjedhur si qyteti mikpritës i Forumit të 4-të të Kryetarëve të Kryeqyteteve të Kinës dhe Vendeve të Europës Qendrore dhe Lindore (EQL) në vitin 2019 që synon të thellojë dhe zgjerojë bashkëpunimin ekonomik, tregtar dhe kulturor me 11 vende anëtare të Bashkimit Europian dhe 5 vende të Ballkanit. Veliaj shprehu bindjen se ky Forum i nivelit të lartë do ta kthejë Tiranën në një epiqendër të mar-



rëdhënieve të Europës me Kinën. "Jam shumë e lumtur, si kryetare e delegacionit të Bashkisë së Pekinit, që marr pjesë në këtë aktivitet. Kemi ardhur nga Pekini në Tiranë me rastin e 10-vjetorit të binjakëzimit mes dy qyteteve tona. Por, gjithashtu, kemi sjellë nga Pekini 24 bredha. E quajmë gjithashtu si bima me gjelbërim të përherëshëm dhe

me këtë simbolizoj edhe një marrëdhënie mes njerëzve, që duhet të ruajë gjithmonë pranverën dhe energjinë. Duke sjellë këtë pemë në Tiranë duam të shprehim në mënyrë simbolike se miqësia mes Pekinit dhe Tiranës do të jetë gjithmonë e gjallë dhe plot vitalitet".-u shpreh kryetarja e delegacionit Yan Aoshuang.

Tekste falas për 190 mijë nxënës të klasave I-IV. Plotësimet duhen vetëm me laps

**Debati për çmimet e librave për klasat V-XII, prindërit: Nuk kanë rritje**

*Librarja: Nuk ka mungesa tekstesh deri më tani*

Voltiza Duro

Për një shtatorit ka nisur procesi i shpërndarjes së teksteve shkollore për nxënësit e sistemit parauniversitar në mbarë vendin. Sipas vendimit të Ministrisë së Arsimit, librat nga klasa e parë deri në të katërt do të jepen falas në shkollat përkatëse, dhe do të kthehen sërish në fund të vitit mësimor. Por gjatë kohës që librat do të jenë në përdorim nga nxënësit, këta të fundit duhet të tregohen shumë të kujdesshëm dhe mos të bëjnë plotësime me stilolapsa apo ngjyra, por vetëm me laps. Aktualisht, për vitin mësimor 2018-2019, do të përfitojnë rreth 190 mijë nxënës libra falas. Vetë prindërit e shohin si një mundësi shumë të mirë dhënien e teksteve falas nga klasa e parë deri në të katërt. Ata shprehen se kjo nisim e Ministrisë së Arsimit është një lehtësim ekonomik për familjet shqiptare. "Sapo mora testet mësimore për djalin që e kam në klasë të tretë. Kjo ishte një dhuratë shumë e bukur pasi përveç paketimit që tërheq shumë fëmijët, librat janë falas. Jemi lehtësuar shumë këtë vit, pasi nuk duhet të paguajmë asnjë lek për testet. Kjo është një zgjidhje e mirë për shumë familje shqiptare që nuk mund të përballojë blerjen e librave, e fëmijët kanë të drejtë të arsimohen të gjithë njësoj, kështu që kjo nisim është shumë pozitive", tregon për "GSH" një prej prindërve.



një librare tregon se deri më tani nuk ka pasur ankesa nga prindërit. "Procesi i shpërndarjes së teksteve mësimore për klasat V-XII të arsimit parauniversitar po ecën shumë mirë. Mungesa e teksteve deri më tani nuk kemi pasur e me shtëpitë botuese furnizimi me tekste po ecën normalisht. Sa për rritjen e çmimeve mund të them se nuk ka rritje dhe deri më tani nuk kemi pasur asnjë ankesë nga prindërit", tregon librarja për "Gazeta Shqiptare". Ndërkohë vetë prindërit shprehen se nuk kanë

paguar shumë para për librat e fëmijëve, krahasuar me një vit më parë. "Po habitem me çmimet që kanë librat këtë vit. Na thanë se do të kishte një rritje me 30%, por fatmirësisht nuk ndodhi kështu. Kam paguar deri në 10 lekë të reja me shumë për një tekst, por kjo nuk më dëmton aspak ekonomikisht", tregon nëna e një nxënëseje në klasën e nëntë. Ndërkaq, shpërndarja e teksteve mësimore për nxënësit e sistemit parauniversitar do të vazhdojë deri në fillimin e vitit të ri shkollore 2018-2019.

**LEHTËSIM EKONOMIK**

"Jemi lehtësuar shumë këtë vit, pasi nuk duhet të paguajmë asnjë lek për testet. Kjo është një zgjidhje e mirë për shumë familje shqiptare që nuk mund të përballojë blerjen e librave, e fëmijët kanë të drejtë të arsimohen të gjithë njësoj, kështu që kjo nisim është shumë pozitive", - tregon për "GSH" një prej prindërve.

**"NUK KA RITJE ÇMIMESH"**

"Po habitem me çmimet që kanë librat këtë vit. Na thanë se do të kishte një rritje me 30%, por fatmirësisht nuk ndodhi kështu. Kam paguar deri në 10 lekë të reja me shumë për një tekst, por kjo nuk më dëmton aspak ekonomikisht", - tregon nëna e një nxënëseje në klasën e nëntë.



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**BANKA E SHQIPERISE**  
**DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT**  
**SEKTORI I PROKURIMIT**

**TENDER I HAPUR KOMBËTAR**

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: **"Blerje e suportit vjetor per serverat e tipit Lenovo / IBM System te Bankes se Shqiperise"**

'Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limitit 1,520,000 Lekë**".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Haliili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411(ext. 4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e paktyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë  
BIC: STANALTR  
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përkshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: **"Blerje e suportit vjetor per serverat e tipit Lenovo / IBM System te Bankes se Shqiperise"**

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë **03 Tetor 2018, ora 11:00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

**TEPELENË** - Një 43-vjeçar është gjetur dje i vranë me armë zjarri në fshatin Rabie të Memaliajt. Bëhet fjalë për 43-vjeçarën Alket Muhaj, i cili është qëlluar për vdekje me plumb pas koke. Burime nga policia lokale bënë me dije se trupi i pajetë i viktimës është gjetur rreth orës 10:10 nga bashkëshortja në tokën e tyre, ku edhe kishte dalë për të kullotur bagëtitë. Sipas bluve, 43-vjeçari dyshohet është qëlluar me dy plumba me snajper në kokë e në gjoks. "Në afërsi të fshatit Rabie, Memaliaj, në rrethana ende të paqarta është vranë me armë zjarri shtetasi A.M., 43 vjeç, banues në Rabie, Memaliaj. Menjëherë pas marrjes së njoftimit në vendngjarje

**Viktima Alket Muhaj informonte blutë në Tiranë**

**Denoncoi parcelat me hashash, vritet me plumb pas koke 43-vjeçari nga Memaliaj**

**REAGIMI I TRITAN SHEHU**

Deputeti i PD-së për qarkun e Gjirokastrës, Tritan Shehu ka reaguar për ngjarjen e ndodhur ditën e djeshme në fshatin Rabie në Memaliaj. Përmes një postimi në rrjetin social "Facebook", Shehu shprehet i shokuar nga ngjarja, duke u shprehur se me këtë krim kuptohet se shteti ka rënë. Sipas tij, vrasja e Muhajit ishte e parapërgatitur, e organizuar dhe e realizuar me snajper nga një dorë "profesionale".

kanë shkuar shërbimet e policisë dhe grupi hetimor; të cilët po punojnë për zbardhjen e rrethanave të ngjarjes, identifikimin dhe

kapjen e autorit/ve", thuhet në njoftimin zyrtar të policisë. Pista kryesore ku janë përqendruar hetimet është se pak ditë më parë Muhaj kishte

sinjalizuar policinë për disa parcela me hashash, të cilat u asgjësuan nga policia. Siç bëhet me dije, 43-vjeçari komunikonte dhe informonte strukturat e policisë në Tiranë, pasi nuk kishte besim te policia lokale. Në lidhje me asgjësimin e parcelave pak ditë më parë, 43-vjeçari ka komunikuar me SHÇKB-në, të cilën e ka informuar për parcelat me hashash, ndërsa SHÇKB e Tiranës, më 4 shtator ka informuar policinë lokale për të ndërhyrë në



Viktima Alket Muhaj

vendin e sinjalizuar. Këta të fundit kanë ndërhyrë dhe kanë asgjësuar 8 parcela me lëndë narkotike, me rreth 4.800 bimë. Por, në lidhje me operacionin e zhvilluar për asgjësimin e bimëve të lëndës narkotike, policia nuk ka dhënë asnjë deklaratë. I vetmi njoftim lidhur me këtë ngjarje është dhënë ditën e

djeshme. "Komisariati i Policisë Tepelenë - Më datë 06.09.2018, u referuan materialet në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastrë; për shtetasit K.C., dhe A.K., vjeç 59 e 33, banues në fshatin Gilavë, për veprën penale parashikuar nga neni 284 i Kodit Penal".

Policia identifikon autorin, në kërkim 49-vjeçari Azis Markola

**Tronditet Mamurrasi, ekzekutohet në derë të shtëpisë 27-vjeçari**


*Shkak, hakmarrja për një plagosje të kryer nga i riu në vitin 2012*

**MAMURRAS**

**T**ronditet Mamurrasi. Pa kaluar as 24 orë nga vrasja me thikë e një 14-vjeçari, një tjetër ngjarje tjetër e rëndë ka shokuar banorët e zonës. Indrit Pepa është ekzekutuar me breshëri automatiku në derë të shtëpisë. Burime zyrtare nga policia bënë me dije se i riu u vra në orët e para të mëngjesit të djeshëm afër xhamisë, në lagjen "Zef Hoti" (periferi të Mamurrasit). Menjëherë në vendngjarje kanë shkuar blutë, të cilët kanë nisur hetimet. Pas kryerjes së veprimeve hetimore paraprahe, policia ka mundur të identifikojë autorin e krimit, i cili është shpallur në kërkim. Bëhet fjalë për 49-vjeçarën Azis Markola. Paraprakisht dyshohet se 27-vjeçari Pepa, baba i një vajze 3 vjeçe është vranë për hakmarrje. Mësohet se viktima para 6 vitesh ka plagosur Markolën, i cili ka vendosur të hakmerret.

**VRASJA**

Rreth orës 04:30 të ditës së djeshme, banorët e qytetit të Mamurrasit janë zgjuar të terrorizuar nga breshëritë e automatikut, ndaj menjëherë kanë njoftuar policinë. Nga breshëria e plumbave ka mbetur i plagosur rëndë Indrit Pepa. Sipas burimeve të mësipërme, 27-vjeçari është qëlluar sapa ka dalë nga banesa. Për pasojë, ai ka mbetur i plagosur rëndë. Menjëherë i riu është transportuar për në Spitalin e Traumës në Tiranë, por fatkeqësisht ka ndërruar jetë gjatë rrugës për shkak të plagëve të rënda që kishte marrë. Falë veprimeve të shpejta hetimore, policia bëri të mundur identifikimin e autorit të krimit. Blutë po punojnë intensivisht për kapjen e



27-vjeçari i vranë, Indrit Pepa

ekzekutorit Azis Markola. Ndërkaq, burimet e mësipërme pohuan se Indrit Pepa jetonte prej kohësh jashtë

Shqipërisë. Ai kishte pak kohë që ishte kthyer në vendlindje, të familja e tij, e cila qëndronte e ngjujar



prej 6 vitesh. Mësohet se në vitin 2012, Pepa është konfliktuar me Markolën dhe në sherr e sipër e ka plagosur

rëndë atë. Pas kësaj ngjarjeje, i riu është larguar jashtë vendit, ndërsa familja e tij është ngjujar.

**Deputeti i PS-së: Policinë e Kurbinit e drejtojnë ordinerët, do protestoj**

Deputeti socialist i zonës, Gjetan Gjetani akuzoi drejtuesit e policisë së Kurbinit, si të korruptuar, të paafët dhe ordinerë. Ai thotë se do të kërkojë interpelancë me ministrin e Brendshëm, Fatmir Xhafaj për të kërkuar shkarkimin e drejtuesve të Policisë në Kurbini. Në rast se kjo nuk ndodh, Gjetani thotë se është i gatshëm të dalë në protestë, pavarësisht ngjyrave politike. Ngjarjet e fundit të ndodhura në Kurbini më kanë shqetësuar shumë, duke bërë që të mos ndjehem të sigurt. Eksploziv, kërcënim me armë dhe vrasja e dy të rinjve tregon që policia është hallkë shtetërore shumë e paafët. Kjo tregon se në Kurbini kanë sjellë oficerë dhe drejtues policie të paafët, të korruptuar dhe ordinerë. Si deputet i kësaj zone, kam pasur ankesa të shumta nga qytetarët, të cilat do t'i bëj publike në parlament. Brenda muajit shtator do kërkoj interpelancë me ministrin e Brendshëm dhe nëse nuk do të marrë masa për pastrimin e Komisarariatit të policisë së Kurbini, unë i pari do ngrihem në protestë, duke kërkuar mbështetjen e gjithë qytetarëve të Kurbinit pa marrë parasysh ngjyrat politike.

**Babai nxiti djalin të vriste 14-vjeçarin: "Merre thikën vrite, ose s'je djalë"**



GAZETA SHQIPTARE

**MAMURRAS** - "Merre thikën vrite, ose nuk je djalë". Mund të duket e pabesueshme, por krimi në Mamurras ka ardhur si pasojë e nxitjes nga ana e babait të autorit 15-vjeçar. Ky i fundit vrau bashkëmohatarin e tij mbremjen e së mërkurës në Fushë-Mamurras. Ndërkohë që tashmë është vënë në

pranga edhe babai i autorit. Burime të "Gazeta Shqiptare" kanë bërë të ditur se Xhevdet Xhecuka dyshohet se ka nxitur krimin. Kjo, referuar dëshmisë së djalit të tij të mitur që mësohet të ketë thënë se babai i tha: "Merre thikën vrite, ose nuk je djalë". Dhe menjëherë pas rrëfimit të djalit, i ati i tij ka

rënë në prangat e policisë. Konflikti mes minorëve ka qenë i castit dhe fillimisht ata janë zënë me grushte me njëri-tjetrin, shumë pranë shtëpisë. Më pas e gjitha përfundoi tragjikisht. 14-vjeçari me inicalet A.S. vdiq menjëherë. Tashmë babë e bir ndodhen pas hekurave.

ME "LOOK" TË RI DHE PA TË BRENDSHME, ROZA LATI 'NDEZ' RRJETIN

# SUMMER

pages

SUPLEMENT I GAZETA SHQIPTARE

E premte 7 Shtator 2018



**VALBONA SELIMLLARI, PJESE  
E NJË EMISIONI TË RI?**



**Luana Vjollca i lë  
pa frymë ndjekësit**

**BULEVARDI  
POLITIK**



- Mbrëmje e veçantë për Namik Doklen, ish-deputeti marton djalin
- Ministri Bushati duke udhëtuar me avion, prezanton miken e tij të re
- Olta Xhaçka s'ia ndan sytë ministres Gjonaj, Hyseni i 'hap' arkivat Vasilika Hysit
- 'Ëndrra e Azemit: Shqipëria si Europa', Rudina Hajdari përkujton të atin



Rrëfihet zëvendësministri: Sfidat i japin kuptim jetës, ja për çfarë luftoj

# **SHPAT KOLGEGA:** **Vazhdoj ta blej vetë bukën te furra**

*"Lindita Nikolla është  
mbështetësja ime më e madhe"*

Reëfhet zëvendësministri: Sfidat i japin kuptim jetës, ja për çfarë luftoj

# SHPAT KOLGEGA:

## Vazhdoj ta blej vetë bukën te furra

*"Lindita Nikolla është mbështetësja ime më e madhe"*

Egla Xhemali

**T**ë kesh post të lartë nuk do të thotë që të humbasësh thjeshtësinë. Këtë na e vërteton më së miri zëvendësministri i Arsimit, Shpat Kolgega, i cili vjen në një rrëfim ekskluziv për "Summer Pages" të "Gazeta shqiptare", siç nuk e keni parë kurrë. Për të nuk ka ndryshuar asgjë, që prej marrjes së postit, pa harruar këtu përgjegjësitë dhe punën e fortë që duhet të bëjë për fushën e arsimit. Sfidat për zëvendësministrin nuk janë të pakta, megjithatë ai i pëlqen ato. Detyrën që mban nuk e ka qëllim në vetvete, por do të lërë gjurmë edhe pasi të mos jetë më në detyrë. Një mbështetje e madhe dhe motivim është ministria Lindita Nikolla dhe kryeministri Rama. Kolgega pohon duke qeshur se shokët i kërkojnë kostumin borxh dhe se janë mësuar tanimë që ta shohin si zyrtar. Përtej politikës, Shpati ndan me ne jetën që bën jashtë petkut të politikantit, duke thënë se del fundjavave dhe nuk dehet kurrë. Një femër ideale sipas tij duhet të jetë shumë këmbëngulëse dhe e pavarur. Raportet me rrjetet sociale duket se nuk i ka aq të mira, mirëpo i duhen për çështje pune. Kolgega na tregon se është i pasuruar me miq të mirë, të cilët ndonjëherë i kërkojnë dhe ndonjë nder të vogël. Sa u përket marrëdhënieve me kolegët opozitarë, ai thotë se i çmon njerëzit me vlera, pavarësisht kahut politik. **Prej një viti je zëvendësministër. Çfarë ka ndryshuar?** Përveç kohës, që është më e zënë dhe takimeve zyrtare, pjesa tjetër ka mbetur e njëjtë. Vazhdoj ende ta blej vetë bukën tek furra poshtë pallatit. (qesh)

**Si është për një djalë të ri ky post?**

Nder i madh. Shumë. Por, edhe emocion dhe përgjegjësi, pasi nuk i jepet çdokujt një mundësi e tillë. Është një punë që e bëj me shumë dashuri dhe një motiv i bukur për t'u zgjuar çdo mëngjes. Zakonisht detyra të tilla vijnë kur je me më shumë eksperiencë, ndërsa në rastin tim është eksperiencia vetë.

**Cilat janë sfidat e Shpatit?**

Për momentin janë 3 sfidat e mia. Projektligji i Rinisë, ndërtimi i qendrave të reja rinore dhe karta e studentit. Janë sfida që unë i kam marrë përsipër dhe do t'i çoj deri në fund. Mua më pëlqejnë sfidat, pasi i japin kuptim jetës sime dhe përditshmërisë. Një punë pa sfida për mua do ishte parazitizim.

**Nga çfarë vuan sot rinia shqiptare?**

Ka nevojë për më shumë energji pozitive, nisma të reja, mundësi për aktivitete dhe ambiente rekreative. Për fat të mirë kemi të rinj shumë energjikë, por që duhet t'i kanalizojnë ato për të pasur produkt.

**Si i ke marrëdhëniet me Lindita Nikollën? Po me kryeministrin Rama?**

Shumë të mira. Ministria Nikolla është mbështetësja më e madhe në të gjithë punën time të përditshme. Sigurisht, edhe kryeministri, i cili ka besuar tek unë. **Çfarë të thonë shokët kur të shohin me kostumin e politikantit?**

Ka nga ata që ma kërkojnë kostumin borxh. (qesh) Përtej shakasë, të gjithë miqtë e mi janë mësuar me këtë, pasi prej një kohe të gjatë unë merrem me politikë.

**Po femrave si u dukesh?**

Këtë nuk e di. Jam kurioz, ti ke dëgjuar ndonjë gjë? (qesh)



Për momentin janë 3 sfidat e mia. Projektligji i Rinisë, ndërtimi i qendrave të reja rinore dhe karta e studentit. Janë sfida që unë i kam marrë përsipër dhe do t'i çoj deri në fund

**Duke qenë se në këtë moshë je zëvendësministër, mendon që kur të mos e kesh këtë post do pësosh ulje apo ngritje në karrierë?**

Të them të drejtën, nuk para e mendoj këtë gjë. Unë punoj fort çdo ditë që të jap maksimumin këtu ku jam. Postin nuk e kam qëllim në vetvete, sepse historia e Shqipërisë ka njohur



pafund zëvendësministra. Dua të realizoj diçka që të ngelet edhe kur të mos jem më në detyrë. Në të ardhmen do realizojmë prapë intervista.

**A ka ndonjë politikane që të duket simpatike?**

Është kriter i pamjaftueshëm për të dhënë emra të përveçëm.

**Si do ishte për ty femra ideale?**

E pavarur dhe këmbëngulëse.

**A del në fundjavë?**

Dal dhe më pëlqen që ta shijoj jetën dhe eksploroj Shqipërinë.

**Dehesh ndonjëherë?**

Asnjëherë.

**Ke frikë nga paparacët?**

Frikë është fjalë e madhe, por nëse atyre do u interesonte, maksimumi do më fotografonin duke bërë vrap nga liqeni apo duke shkuar me autobus për në punë, janë të mirëpritur.

**Çaton në rrjetet sociale?**

Nuk më pëlqen, por jam i detyruar për çështje pune. Janë të pashmangshme. Të kërkojnë ndere shokët tani që je zëvendësministër? Edhe shoqet. (qesh) Por më pëlqen t'i ndihmoj njerëzit, kuptohet aty ku kanë të drejtë dhe është e mundur.

**A je pasuruar?**

Me miq e me shokë shumë të mirë, po.

**Si i ke marrëdhëniet me kolegët nga opozita?**

Njerëzit me vlera i çmoj gjithmonë, pavarësisht krahut politik. Brezi ynë duhet të sjellë debatin e argumenteve dhe jo konfliktin personal të interesave.

**Ke menduar ndonjëherë se mund të kishë një punë në sektorin privat dhe të shkëlqejë?**

Unë kam punuar më parë në sektorin privat për disa vite. Mendoj se do ta gjeja veten mirë edhe aty, por pasioni për politikën nuk e ushtron dot në atë sektor. (qesh)


## VALBONA SELIMLLARI, PJESË E NJË EMISIONI TË RI?

Ajo është një nga figurat më të dashura për publikut shqiptar. Prej vitesh tashmë ish-misi i parë shqiptar Valbona Selimllari konsiderohet si një ikonë e vërtetë bukurie. Bukuroshen e kemi parë në spektakle të ndryshme, madje për disa sezone ka drejtuar një emisionin "Nga e para" në Vizion Plus, i cili kishte të bënte me ndërtimin dhe arredimin e një ndërtese nga e para. Megjithatë në këtë sezon të ri televiziv, veçse pjesë e jurisë së 'Dance with me' në 'Klan' është mësuar se ajo do të nisë një emision të saj në 'Ora News'. Fokusi i emisionit do të ketë njerëzit në nevojë. Mbetet për t'u parë se kur do të nisë ky emision i bukuroshes së ekranit.




## LUANA VJOLLCA I LË PA FRYMË NDJEKËSIT

Mesa duket pushimet për Luana Vjollcën nuk paskan mbaruar akoma. Bukuroshja është komentuar shumë nga mediat rozë dhe shkak për këtë janë bërë fotot që ajo ka shpërndarë gjatë këtyre ditëve në rrjetet sociale. Së fundmi, ajo ka postuar një tjetër imazh tejet seksi në një vend të bukur. Trupi me linjat perfekte si dhe ngjyra e bukur që ka marrë nga dielli i ka 'ndezur' komentuesit, të cilët i kanë bërë komplimente nga më të ndryshmet.




## ME "LOOK" TË RI DHE PA TË BRENDSHME, ROZA LATI 'NDEZ' RRJETIN

Roza Lati është ndër moderatorët më të dashura për publikun shqiptar. Ajo është mjaft aktive në rrjetet sociale, duke ndarë me fansat çdo foto dhe video nga aktiviteti i saj i përditshëm. Bukuroshja nuk di të ndalet. Roza ka publikuar një foto mjaft sensuale që ka tërhequr vëmendjen. Teksa jemi mësuar ta shohim bionde, Roza në këtë imazh të fundit vjen me look të ri duke pozuar pa të brendshme. Moderatorja tashmë është kthyer në brune, ndryshim të cilit mesa duket ndjekësit e kanë pritur mjaft mirë pasi ka marrë shumë komente pozitive.



## MORENA TARAKU BËN BLERJEN MARRAMENDËSE

Morena Taraku është një nga personazhet më të komentuar të show bizzit. Dihet që ajo shpenzon shumë për veshje. Së fundi, ku modelja ka treguar në 'Instagram' një palë atlete të reja, që sapo ka blerë. Ndërsa vërehet re se këto atlete janë të firmës Louis Vuitton, atëherë këto duhet të jenë me çmim shumë të lartë. E ashtu edhe është, pasi pikërisht në faqen e firmës së njohur tregon se këto atlete me emrin 'LV Archlight Sneaker' kushtojnë jo më pak se 1,090 dollarë!





*Fiqtë janë një delikatesë e vërtetë, sezonaliteti i të cilëve është mjaft i shkurtër. Pra, në shtator, le të hyjmë brenda dhe të kemi një festë të mirë të këtyre frutave të shijshme .*



# Frutat dhe perimet sezonale që duhen në tryezën tuaj

Dëshironi disa shije të reja? Përfitoni nga fillimi i muajit për të vizituar tregjet dhe rizbuloni frutat dhe perimet e vjeshtës.

I lini pushimet pas krahëve, sepse tani jemi në prag të fillimit të ritmit të zakonshëm frenetik dhe pa ndërprerje të jetës së përditshme. Për të filluar sa më mirë, le të udhëhiqemi nga ngjyrat dhe aromat që na ofron stina e vjeshtës: kush tha se shtatori është vetëm melankoli dhe trishtim?

Le të përpiqemi të shqyrtojmë dhe të zbulojmë se në realitet, natyra na ofron një shumëllojshmëri shijesh që ne duhet vetëm t'i grumbullojmë. Fiqtë: të mirë, të ëmbël, ushqyes. Fiqtë janë një delikatesë e vërtetë, sezonaliteti i të cilëve është mjaft i shkurtër. Pra, në shtator, le të hyjmë brenda dhe të kemi një festë të mirë të këtyre frutave të shijshme me një çmim të arsyeshëm dhe me shkallën e përsosur të pjekjes.

Të shkëlqyeshëm si një meze e lehtë, fiqtë janë, gjithashtu, të përsosur për t'u kombinuar me pjatë të kripura: kush nuk e

çmon proshutën klasike dhe fiqtë? Pastaj nëse kemi mundësi, blejmë disa kilogramë më shumë fiq të pjekur: me ta mund të bëjmë marmelatë, e thjeshtë për t'u përgatitur dhe e përsosur për t'u shijuar me bukë të freskët në mëngjes për të filluar ditën.

Manaferrat: super të shëndetshme, përveçse të shijshme, frutat e pyllit janë shumë të pasura me vlera ushqyese për organizmin tonë. Burimet e antioksidantëve natyralë ju mbajnë të rinj, të shëndetshëm dhe, gjithashtu, të lumtur, sepse janë vërtet të shijshëm, të përsosur për një ëmbëlsirë të lehtë që do të kënaqë shijen pa u rënduar shumë. Nëse nuk kemi mundësi të bëjmë një



udhëtim në pyll, ne shkojmë dhe blejmë në shitore ose në tregje, e rëndësishme është që të jenë të bukura dhe të forta. Për të maksimizuar përfitimet e këtyre frutave, thjesht konsumoni ato pas shpëlarjes nën ujë të rrjedhshëm, pa i lënë ata

të zhyten. Shërbejini ato në një tas të vogël me një lugë akullorë limoni dhe disa gjethë nenexhik: është e pamundur t'i rezistosh!

Kumbulla: Shtatori është pikërisht muaji i kumbullës. Të purpurta ose të verdha, këto ëmbëlsira autentike janë, gjithashtu, të shkëlqyera për përgatitjen e marmelatave të shijshme dhe të shëndetshme në shtëpi. Frutat e sheqer kaq mjafton: ushqim i lehtë dhe mëngjesi do të jetë i përsosur nëse kosit i shtojmë disa lugë marmelatë kumbulle.

Patatë të reja: pjatë e pazëvendësueshme anë-

sore për rosto, patatet janë të pashmangshme në supet e perimeve. Me fillimin e vjeshtës, dhe me temperaturat e buta, shohet dëshira për të përdorur sërish furrën: asgjë më e mirë se të rifillojë receta dhe të japë ndjeshmërinë e krijimtarisë duke përdorur këtë përbërës të çmuar. Mishi i fortë i patateve të reja, të cilat janë në sezon në këtë kohë të vitit, është i përkryer për çdo përgatitje, përfshirë patatet e furrës, për t'u gatuar në çdo kohë dhe jo vetëm të enjteve!

Fasule: burim i shkëlqyer i proteinave bimore, fasulet duhet gjithmonë të jenë të pranishme në një dietë të ekuilibruar, me yndyrë të ulët dhe me një buxhet të shtrënguar. Në shtator është e mundur të blesh ato të freskëtat. Fasulet janë të përsosura për t'u shoqëruar me një sallatë të zakonshme ose me brumëra si një klasik të përjetshëm, por, gjithashtu, reduktohet në pure dhe shndërrohet në burger vegan ose madje, të kombinuara me patate, për të përgatitur qofte të shijshme për t'u shërbyer nëse kosit i shtojmë disa lugë marmelatë kumbulle. Patatë të reja: pjatë e pazëvendësueshme anë-





## Ministri Bushati duke udhëtuar me avion, prezanton miken e tij të re

Ministri i Punëve të Jashtme, Ditmir Bushati ka postuar së fundmi një video nga udhëtimi i tij me avion. Gjatë udhëtimit Bushati ka takuar një vajzë të vogël me origjinë shqiptare, e cila vazhdon të shkollën në Arabi. Në video ministri shihet teksa e pyet vajzën për shkollën, ndërkohë ajo është së bashku me familjarët e saj në të njëjtin avion me të.



## Olta Xhaçka s'ia ndan sytë ministres Gjonaj, Hyseni i 'hap' arkivat Vasilika Hysit



Deputetët e Kuvendit janë mbledhur sërisht për të zhvilluar seancën plenare, por edhe kësaj here në mungesë të opozitës. Fotografi Agim Rama ka shkrepur disa momente shumë interesante nga seanca. Në njërin prej fotove duken dy ministrat Ahmetaj dhe Gjijnuri, të cilët po flasin me njëri-tjetrin duke shkëmbyer edhe të qeshura. Të shoqëruara me njëra-tjetrën janë edhe dy ministret Olta Xhaçka dhe Etilda Gjoni, të cilat ndryshe nga ministrat janë më serioze në fytyrë. Por fotoja më pikante e ditës është ajo mes dy deputetëve Alket Hyseni dhe Vasilika Hysi. Në foto duket Hyseni, i cili i tregon në celularin e tij, një foto të Vasilikës. Të qeshura me Gjijnurin ka shkëmbyer edhe kryeparlamentari Ruçi dhe kryeministri Rama. Në tërësi, në fotot e shkrepura socialistët janë shfaqur të qeshur dhe pa tension, ndoshta kjo edhe nga mungesa e opozitës.

# BULEVARDI POLITIK

*Në merrni seriozitet!* 🤪

## 'Ëndrra e Azemit: Shqipëria si Europa', Rudina Hajdari përkujton të atin



Vetëm për pak ditë bëhen plot 20 vite nga vrasja e Azem Hajdarit. Vajza e tij Rudina Hajdari, deputete e Partisë Demokratike, ka vendosur të kujtojë të atin duke sjellë ndërmend ëndrrën dhe qëllimin e tij. Me anë të një postimi në 'Instagram' Rudina na kujton se ëndrra e së atit ishte ta bënte Shqipërinë si Europa, një synim ky dhe i qeveritarëve të sotëm. "Ëndrra akoma jeton. 20 vite, 12 shtator 2018", shkruan deputetja. Azem Hajdari u vra në Tiranë më 12 shtator 1998, pas 6 ditësh bëhen 20 vite nga vdekja e tij.

## Mbrëmje e veçantë për Namik Doklen, ish-deputeti marton djalin

Moment i veçantë ka qenë ai i javës që shkoi për ish-deputetin e PS, Namik Dokle. Ish-deputeti ka martuar djalin. Lajmin e ka bërë të ditur vajza e ish-deputetit, Anika Dokle. Kjo e fundit ka ndarë me ndjekësit në 'Facebook' momente nga ceremonia e dasmës. Siç shihet nga pamjet, ceremonia ka qenë e thjeshtë me pak të ftuar. Ndërsa bie në sy atmosfera e zjarrtë dhe gëzimi. Në një nga videot shihet teksa Dokle këndon dhe duket më i lumtur se kurrë. "Dashuria është esenca e jetës", shkruan ajo në përshkrimin e postimeve që ka ndarë me ndjekësit.



## PERSONAZH

Arshi Pipa kujton letrën e saj të mbrame, të mbuluar me njolla lotësh, ku edhe shkrimi dukej i thyer, ishte letra përgjigje e Bedit, ndaj letrës që vëllai i kishte shkruar

# BEDI PIPA

## Një ditar intim, historia e trishtë e motrës së Arshi Pipës

Nga Miranda Haxhia

**E**butë dhe e egër" - Kështu e përshkruan ajo veten në një letër. Ndoshta ajo nuk ka nevojë të shkruajë dikush pas kaq shumë vitesh për profilin e saj. Ka lindur në një botë tjetër, është rritur në një familje që sot, imagjinata e mangët na pengon ta përfytyrojmë me tërë fisnikërinë, hirshmërinë dhe zakonet. Por, jam e bindur se po të kishte jetuar gjatë, do të kishte një jetë të shënjuar nga ana intelektuale ose do ishte fundosur si të tjera, si ajo, në burgjet e komunizmit. Sapo mbarova së lexuari "Ditari Intim" të shkruar nga Bedi Pipa. Atë libër e mora shkarazi nga rafti në prag udhëtimit, para disa ditësh. 'Meqë është i hollë' mendova, duke e zbehur vlerën e librit në numra faqesh. Meqë më kishte ngacmuar mbiemri i autores, ditën kur e bleva dhe meqë intuïta më thoshte se është libër që do të zinte vend në skutat e kujtesës sime. Nuk u gabova. Prej ditësh, ky libër i përfunduar po rilexohet në nënvetëdijen time. Dhe kam kuptuar se njerëzit që kanë jetuar në Shqipëri në viteve '30-40' e deri në '50 kanë pasur një lloj vllage etike, kulture dhe prezence që është për t'u pasur zili.

### HISTORIA E BOTIMIT

Vëllai i Bedi Pipës, Arshi Pipa, kujton në "Paraqitje lexeuse në faqet e fillimit të librit se, pasi ishte kthyer nga burgu, po merrej me sistemimin e shënimeve, shkriemeve, botimeve që gjeti në shtëpi e që disa nuk ishin të tija. Ishin pa emër, por nga shkrimi, ai e kuptoi se i përkisnin motrës së tij të vdekur: tri fletore, të mbushura me shkrim, diku të shpeshtë, diku të qartë, diku të ngatërruar. Ndër to, kishte edhe fletë të shkëputura.

E papritura, pasi i lexoi, ishte jo gjetja e tyre, por ajo çka shkruhej. Dhe ai rrëfen: "Më ka qillue me vërejtje gjatë burgimit natyna të mbylluna, të cilat nuk ndiejshin nevojë për shoqni; veç vrejshin në botën e tyne, në mes të moris gjithë zhurmë e poterë, e jetojshin ashtu, të ndrymë mbrenda kullës së hekurt të vetvetes në një mendim të qëndrueshëm ose në një andërr të vazhdueshme. E kam ndeshë edhe natyra, të cilat, pa u shty deri ktu, nuk ja çelshin as shokut botën e tyne të brendshme. Ti rrijshe me ta, flitsh e qeshesh me ta, por ndjenjat e qëllimet e tyne të



thella të ngeleshin të panjof-tuna. Kam vërejtë se shoqnia e burgut ka shumë pikëtakime me jetën familjare. Prandaj, tue lexue kto fletore, nuk u çudita fort që nuk e kisha njoftë motrën time."

### PËR AQ SA JETOI...

...Sepse ajo u nda nga jeta kur ishte njëzetë e katër vjeç, në vitin 1948, nga një sëmundje e papritur e mushkërive. E goditi përfundimisht ridënimi i vëllait të saj të dashur, me të cilin qe e lidhur fort, pasi ishin rritur bashkë, ishin pranë njëri-tjetrit kur ajo ndiqte shkollën Normale në Tiranë, pastaj, sërisht bashkë në Shkodër e mandej në Tiranë, ku u transferuan në vitin 1943. Burgu i Arshiut i ndau. Arshi Pipa kujton letrën e saj të mbrame, të mbuluar me njolla lotësh, ku edhe shkrimi dukej i thyer, ishte letra përgjigje e Bedit, ndaj letrës që vëllai i kishte shkruar, ku i tregonte se e kishin dënuar rishtazi për dhjetë vjet (e që nuk do t'ia falte kurrë vetes që ia tregoi).

E kishte ëndërr shkollimin në një universitet jashtë vendit. Por kjo ëndërr i

mbeti e porealizuar për shkak të pështjellimeve politike. U emërua mësuese në qytet, detyrë që nuk e kishte fort për zemër e mbas pak kohe u sëmur.

Arshi Pipa kujton se nuk ka mundur të ruajë letrat e saj të fundit. Në shënime nuk flitet gjëkund për lëngatën e saj pasi, siç shpjegon A.P., "intimiteti i lëngatës nuk asht një pamje e mirë për sytë e tjetrit, dhe ka gjana që vetëm heshtja mund t'i shprehë".

### PËRSE "DITARI INTIM" KA NJË PËRMASË PËRTEJ INTIMES?

Ditari i Bedi Pipës fillon me përshkrim të kohës kur ajo jetonte, të përshkruara nga një melankoli e theksuar që mbërrin deri te ideja e vdekjes. Shenja si: kujdesi i një introspekcioni, konstataimi i variabilitetit psikik dhe i fazave të tij, kërkimi i shkakut për gjendjen, zbulimi i dy natyrave të ndryshme në veten, orvatja për të sunduar vuajtjen duke e fshehur, mendimi origjinal i paralelizmit psiko-fizik i vuajtjes përshkruajnë shënime të këtij Ditari.

Bedin e kupton se është një lexuese e Baudelaire-it,

### Letra e fundit e të vëllait: Më dënuan 10 vite

Leopardi-t, Schopenhauer-it, Dostojevski-t, Migjenit, të cilin e kishte njohur herët nga i vëllai, Chopin-it. Bedi nuk e pranon se ka "preteza letrare", por pasi e lexova librin e saj, jam e bindur se po të kishte jetuar, ose më saktë, po ta kishin lënë të bënte jetën e saj, me gjithë formimin e duhur, ajo do ishte një emër i çmuar në kulturën letrare. Pasi, mënyra e të shkruarit, logjika, arsyeja dhe filli i mendimeve të kësaj vajze njëzet vjeçare diktojnë një mendje që ka prirje për t'i dhënë vlera shoqërisë.

Pas leximit, përfytyrova Bedi Pipën: e brishtë, e mbyllur, me vullnet dhe me kurajë për të eksperimentuar detaje që lodhen me të menduarit, varësinë e vullnetit me inteligjencën. Por ajo që më tërhoqi është një tisi i hollë, i bukur dhe i paparë i një sjelljeje të përkorë. Mënyra si e



përjeton ajo dashurinë, forma me të cilën i merr qakthen përgjigjet, ka kaq shumë ëndje dhe të ngacmon të kuptosh se edhe ajo Tirana e asaj kohe, me shtëpi të ulëta e rrugica të ngushta, po mbushej me njerëz dhe familje që e meritonin plotësisht qytetarinë.



Ajo eksploron vetveten në ditarin e saj intim. Nuk është vetëm ëndja e soditjes së një objekti, as një ëndje estetike që mund të krahasohet me atë të një gruaje të bukur kur sodit trupin e vet para pasqyrës. Qëllimi i shkriemeve të saj është njohja e vetvetes, dëshira e pandalshme për të ditur caqet e veta, forcën dhe dobësinë e vetes, thelbin e vërtetë të vetes dhe lëvoret që e mbulojnë. Ajo arrin të dyzojë shpirtin duke krijuar objektin dhe subjektin. Kjo njohje nga një qëllim teorik, shndërrohet në një qëllim moral. "Unë nuk jam një femer e jashtëzakonshme, jam para së gjithash një kenje qi mendon e ndien në mënyrën e vet" shkruan ajo, duke na dhënë çelësin e personalitetit të saj. E më tej shtjellon: "Zot, sa vuez kur ndokush, edhe padashtun, edhe pa paramendim, më krahason ose më tipizon!"

Ajo vdiq në një dhomë spitali, larg të dashurve të vet, ndër vuajtje të mëdha. Pasi ka shkruar këto fletë, ndoshta ka patur një ngushëllim: ngushëllim që ka njeriu kur i ngre një varr të bukur të dashurit të vet.

Arshi Pipa shkruan plot dhimbje: "Se vorri i saj nuk asht aty ku gjindet. Asht një vorri i thjeshtë, me dy gurë mermeri në skaje. Por ash gjithmonë një vorr, ndërsa aj i tim vëllai nuk ka qenë kurr. Çka kam shkruar në këtë botim, është epitafti i atij vorri që ajo vetë i kishte përgatitë vetes... O motër, varri yt asht brenda meje!"

### PËR VETE DHE PËR TË TJERAT

Bedi Pipa ndoshta nuk ka nevojë që ne ta lexojmë, apo ta përmendim. Besoj se kemi ne nevojë për të, për modelin e saj, për historinë që sillet rreth familjeve shqiptare dhe vlerave të humbura në kohë, për pasurinë e paçmuar gjuhësore që sjell gëgnishta e Ditari dhe së fundmi, për të kuptuar se të njohësh veten është gjithmonë shenjë e një vullneti të epërm, por të kapshëm.

EKSPOZITA



# Fantazmat e mundshme, roboti i KFOR dhe kufijtë mendorë

Fatmira Nikolli

Një perde (në tri ngjyra) vjollcë në harkimin e një robe që e merr era, zë vend si pengesa e parë për të hyrë në ekspozitën e Flaka Haliti në Galerinë Kombëtare të Arteve në Tiranë. “KËTU – APO ATJE, ËSHTË MË ATJE” si një pyetje pa pikëpyetje dhe pa nevojën për të marrë një përgjigje, shërben jo vetëm si titull, por edhe si koncept i të mundshmeve të paarrira. Shumëka që do të ishte e mundshme përbashkohet në të njëjtin ambient. Ndonëse mediumet janë të ndryshme dhe variojnë nga vizatimi në skulpturë, për Halitin përcaktimet goftë edhe në mediumin artistik, përbëjnë kufij që duhen kapërcyer.

Ajo krijon distancë prej ngjarjeve dhe burimeve në të cilat e për të cilat vepra e saj lind a merr jetë, duke u bërë më tej, kreyt e ftohtë dhe me një gjuhë të drunjtë mbi e përtej kombeve.

Ndonëse një robot mund të ndërtohet me skrap të marrë nga kampet ushtarake të KFOR-it në Kosovë, pamja dhe mesazhi i tij, sikundër ai i platformave të drunjtë që ngjajnë prej betoni, largohen sa prej KFOR-it edhe prej Kosovës, megjithëse ajo është përherë aty, si temë e fshehur në të mundshmet e paarrira.

**ROBOTI I KFOR**

Nën titullin “Its urgency got lost in reverse (while being in constant delay)” roboti është vënë në një platformë që shpërfaq një realitet sa hapësiror po aq edhe tokësor. Realizimi i veprës me objekte të gjetura në kampet ushtarake të KFOR-it në Kosovë, tanimë të ricikluara rimarrin tjetër sens. Transformimi, pasi materialet janë përmbytur kanë dhënë një formë e përm-



batjtë të re. Roboti në ngjyrë jeshile është në ekspozitë vetëm një prej “fantazmave” a shpirttrave që rri përkrah 25 banerave-flamuj që përbëjnë identitete e fantazma të tjera në vetvete. Ndërsa roboti është statik, i qëndrueshëm e i palëvizshëm në pasqyrimin e tij, krahët e një engjëlli presin në pakohësi një takim të mundshëm; flamujt-banera luhaten lehtë. Vetë Haliti thotë: “Ata janë si fantazma, si shpirttra që qëndrojnë kudo në forma të ndryshme, dhe na japin në një farë drejtimi se cilën rrugë të marrim. Roboti është vënë në një pod, pas tij është një mur, në shpinë të të cilit, në anën tjetër, janë vënë krahë engjëlli. E megjithëse podi rrotullohet dhe si roboti edhe krahët janë në lëvizje, takimi mes tyre nuk arrihet. Potenciali është, por nuk ndodh takimi”.

Puna e saj nuk jep përshtypjen se lidhet me Kosovën. “Po. I tejkaloj kufijtë nacionalë edhe estetikisht shumë prej punimeve mundohet na humbasin burimin se prej ku nis historia, ku është fillesa. E hap mundësinë e interpretimit, ka të tjera

horizonte, i jep të tjera mundësi të ardhmërive”. **“UNË E SHOH NJË FYTYRË...”**

“Unë e shoh një fytyrë. Apo e sheh edhe ti një fytyrë” është një seri imazhesh me fokus qiellin e retë. Është për Flakën një pyetje përgjigjia e së cilës nuk është se pritët. Është si një projektim refleksioni. Kur e pyet nëse për të vetëm qielli limit, ajo thotë se është mundësi e pafundme, por vjen edhe si një farë ngjyre e metafore, e hapjes së kufijve. “Te Pavijoni i Kosovës në Venecia, titulli ishte ‘Spekulimi në të kaltrën’. E kaltra hyn në shumë punë të miat si spekulim i vazhdueshëm, mbi perceptimin që na jep goftë për Bashkimin Europian goftë më gjerë”.

**KUFIJTË**  
Kufijtë si ndalesë e si pragje për t’u kapërcyer gjenden më shumë nëse logjikohet ajo që mungon, jo ajo që është e pranishme. A ka gjasë vendi ku ka lin-

*Flaka Haliti çel në Galerinë Kombëtare ekspozitën “Këtu-apo atje, është më atje”*



Nuk merrem vetëm me kufijtë e territorit. Janë edhe kufijtë mendorë në të njëjtën kohë, dhe të gjithë kufijtë e mundshëm”, - thotë Flaka.

Kur e pyet për kufijtë që ajo vetë ka thyer, Flaka nuk do ta personalizojë ekspozitën. “Kjo do të ishte një deklaratë e madhe që ta bëjë unë për veten. Nuk dua të them çfarë kam bërë unë. Është rreth negociimit të përhershëm, se cilat janë mënyrat për të shpëtuar nga rregulli sistematik. Rregulli i shoqërisë përmes të cilit të tregohet se kjo është mënyra; nga shkolla, te prindërit, mësuesit, miqtë, tregu. Është më shumë për mënyrën se si negociom, hapësirën tënde konformiste me hapësirën konformiste të të tjerëve. Ku fillon hapësira jote e ku përfundon në momentin që hapësira jote e bën të ndjehet jo rehat dikë tjetër”.

Për të, më të vështirë se kufijtë fizikë janë kufijtë fantazmë. “Shumica e kufijve janë kufijtë imagjnativë, që ne i bëjmë më të mëdhenj se sa janë. Derisa provojme t’i sfidojmë”.

Gjen kështoj në të njëjtën hapësirë atë që kuratorja e sheh si një fantazmë që është lënë e pa shqetësuar, duke krijuar dimensione të përkohshme e dinamike që nuk lejojnë një interpretim konkret. Ato kanë mënyra të ndryshme perceptimi nga sekush,

sepse Flaka ka në një mënyrë një qëndrim që bart të drejtën për të mos u kuptuar, sikundër të drejtën për ta mbajtur një qëndrim goftë ky edhe i pakuptueshëm, vetëm për t’u përfaqësuar.

E konceptuar si pasqyrë e punës së Halitit në këto

pesë vitet e fundit, ekspozita e parë personale e saj në Shqipëri është një përzgjedhje punësh që në mënyrë të vazhdueshme transgresojnë kufijtë fizikë dhe mendorë. Ato jo vetëm që refuzojnë klasifikimet tradicionale sipas mediumit, siç është skulptura, piktura, vizatimi apo fotografia, por ato sfidojnë edhe përfundimet e nxituara estetike që janë pasojë e mendimeve cliché mbi një gjeneratë, gjeni apo përkatësi.

Një perde transparente të cilës i ndryshojnë ngjyrat, që siç thotë edhe titulli “rri varur kot” (just hanging around) - këtu, apo atje - e ndërpret në mes korridorin linear. Banerë të ngjyrosur me sprej, të pezulluar nga ekzistenca e tyre e përditshme fantazmagorike, i drejtojnë vizitorët nëpër hapësirat gjarpëruese. Elementet arkitekturale, që duken si muret mbrojtëse që dikur rrethonin ndërtesat e OKB-së dhe NATO-s në Prishtinë, rrinë të shtrira në një gjendje letargjie, tashmë pa as edhe një funksion. Një robot me krahë i ndërtuar nga mbetjet e kampeve ushtarake të NATO-s në Kosovë ngjan si mishërim i dickaje mes një engjëlli të historisë dhe një lajmëtarit me inteligjencë artificiale nga e ardhmja. Dhe përderisa publiku përballet me retë-si-fytyra që duken si shembëllyra të vetkrijtura, një personazh enigmatik me emrin “Joe”, na del para kreyt papritur, në forma të ndryshme antropomorlike në sfungjer-mermeri, ndërsa një trup tjetër abstrakt kryqëzon gishtat pas shpinës.

“Këtu - apo atje, është më atje” është prezantuar për herë të parë në Kunsthalles Lingen (14 tetor, 2017-14 janar, 2018) dhe më vonë në Kunsthaus Hamburg (20 mars-20 maj, 2018). Ekspozita në Tiranë është kuruar nga Leonie Radine.





Dje në "Deutsche Welle"

# Kosovarët e serbët vendosin duart në hartë

Nga Volker Wagener

(vijon nga faqja 1)


... para 20 vitesh u bë zhvendosja e kufijve në bazë të kriterëve etnike-kulturorë. Faktet për këtë u krijuan më parë me dhunë. Tani po tentojnë Kosova dhe Serbia të përsërisin pikërisht këtë, por me një ndryshim: ato duan të bien në ujdi për kufijtë. Ende janë të paqarta objektet që do të këmbehen, por duket se "deal" është gati. Një projekt me rrezik për të gjithë rajonin.

### Një plan si shkëmbimi në bursë

Prej më shumë se shtatë vitesh Kosova dhe Serbia negociojnë nën moderimin e së ngarkuarës për Politikën e Jashtme të BE, Federica Mogherini, që përpigjet të bëjë të pamundurën të mundur. Çmimi i një ujdje është pikant. Parimi bazik gati i BE për mosndryshimin e kufijve është kthyer kokëposhtë, sepse plani duket se është - "më jep mua këtë, të jap atë". Do të ishte e kundërta e asaj që BE e nënvizon prej vitesh: të stabilizojë e jo të ndajë shoqëritë multietnike. Kosova si shtet i ri është faktikisht në Europë e pakontestuar, vetëm pak vende në BE, që kanë vetë probleme me separatizmin nuk e kanë njohur. Pushteti i faktikes u jep kosovarëve një pozicion ndërmjetësimi, që para dhjetë vitesh vetëm mund ta ëndërronin. Për dorëzimin e veriut të Kosovës Serbisë, ku jetojnë afër 45.000 serbë, Prishtina mund të marrë Luglinën e Preshevës në Serbinë Jugore si kompensim. Një rajon kompakt me shqiptarë. Por, tregtia me territoret përçaj të strukturave etnike të popullsisë është vetëm një kriter. Bëhet fjalë edhe për burime dhe monumente kulturore. Nëse nga njëra anë palët shohin interesa ekonomike, humbja me gasë e kishave ortodokse dhe manastireve zgjon tek serbët ndjenjat kombëtare, sepse Fushë-Kosova shihet nga serbët si "djep i Serbisë".

### Miti dhe lufta - parahistoria

Fushë-Kosova, që në Mesjetë ishte një qendër ngulimi e serbëve, humbi pjesë-pjesë me marshimin e ushtrisë osmane në rajon. Nga ana politike miti i Fushë-Kosovës është sjellë e risjellë për propagandë rregullisht, me pasojat më të rënda në vitin 1989, kur Slobodan Millosheviçi i hoqi autonominë Kosovës, 600 vite pas betejës legjendarë të Kosovës. Kjo ishte ora që ra për shpërbërjen e Jugosllavisë, fundi i së cilës kërkoi jetën e më shumë se një çerekmillioni viktimash. Kur u ulën armët në Slloveni, Kroaci, dhe Bosnje e Hercegovinë shpërtheu konflikti i Kosovës në pranverën e vitit 1998. Mediat raportuan për dëbimin sistem-



atik të shqiptarëve nga serbët, shumë janë dokumentuar, ka pasur edhe inskenime. Pas kësaj filloi një maratonë negociatash, pas dështimit të të cilave, NATO sulmoi nga ajri Serbinë duke bombarduar 90 ditë rresht objektiva serbe. Kosova që u fut nën protektoratin ndërkombëtar përjetoi një fazë tranzicioni që mori fund më 17 shkurt 2008 me shpalljen e pavarësisë së Kosovës, shteti më i ri i Europës.

### Skenarë me rreziqe pasuese

Nëse arrihet të bëhet një këmbim territore mes Kosovës dhe Serbisë, në Ballkan do të ndizej fitilli, të paktën juridikisht. Si pasojë, të tjerë në rajon mund të ndiznin zjarrin. Më vështirë është të parashikohen pasojat në Bosnje-Hercegovinë. Përfaqësuesit e vijës së ashpër në Republikën Srpska nuk i kanë varrosur asnjëherë planet e tyre për bashkimin me Serbinë, por i kanë lenë vetëm përkohësisht mënjanë. Po kjo vlen edhe për nacionalistët kroatë në Hercegovinën Perëndimore, që po të mundnin do të bëheshin që sot pjesë e Kroacisë. Por edhe Maqedonia dhe Mali i Zi janë shoqëri

multietnike.

Në mënyrë paradoksale, këmbimi i territoreve i kontestuar si nga ana juridike edhe politike i afron këto vende më shumë me BE. Të dyja vendet duan të futen në një plan afatmesëm në familjen europiane, por kanë ende përpara plotësimin e kriterëve.

Edhe këtu ka pozicione kundërtëne. Nëse presidenti francez Macron kërkon të arrijë perfeksionimin e BE, dhe e frenon zgjerimin e unionit, të tjerë duan t'i sjellin në rrugën e duhur këto vende, si pjesë e BE, para se t'i lenë këto vende nën influencën e Kinës, Turqisë apo Rusisë.

### Kush është pro kush është kundër?

Lista e përkrahësve dhe kundërshtarëve të planit të këmbimit të territoreve është e gjatë. Këshilltari i Trumpit për sigurinë, John Bolton, e ka mbështetur një "deal" mes vendeve. Se sa do të rezistojë qip pozicion nuk ka rëndësi para rënies së dukshme të interesit të politikës së jashtë me amerikane ndaj çështjeve europiane.

Qeveria gjermane, edhe kancelarja Merkel, është e përmbajtur. Po ashtu edhe burrat kompetentë të shtetit, Carl Bildt, ish-i ngarkuari i BE për Jugosllavinë dhe Wolfgang Ischinger, një nga autorët e Marrëveshjes së Dejtonit. Edhe eksperti i njohur i Ballkanit dhe dora e djathtë e Richard Holbrooke në Bosnje, James W. Pardew flet kundër këmbimit të territoreve. Tek kritikët e idesë bën pjesë edhe Christian Schwarz-Schilling, ish-ministër i kabinetit të Helmut Kohlit, si edhe paraardhësi i tij si përfaqësues ndërkombëtar në Bosnje-Hercegovinë, Paddy Ashton.

Por ora politike po troket. Më 8 shtator, njeriu i fortë i Serbisë, Aleksander Vučić do të mbajë para serbëve në Mitrovicë, "fjalimin më të madh të jetës së tij". Oferta e tij është në fakt një leksion interesant për transformimin e një fajkoi nacionalist në europian. Sepse Serbia kërkon të hyjë në klubin europian. Pikëllimi për humbjen e pjesmme të "djepit të Serbisë" duket të jetë i përmbajtur në Beograd.

## HOROSKOPI

### DASHI

Do ta keni të vështirë të përqendroheni në punën tuaj. Një çështje dashurore ju shkakton shumë stres. Sa i përket financave suksesi është i mundur nëse i kushtoni vëmendje shpenzimeve.

### DEMI

Do ta keni të vështirë që të kontrolloni emocionet tuaja, por mos u bëni negativë ndaj njerëzve që janë jush pasi rrezikoni që të mbeten vetëm. Mos iu dorëzoni kërkesave emocionale të të dashurit tuaj.

### BINJAKET

Problemet që lidhen me shëndetin mund të shkaktojnë siklet dhe ankth. Stresi nuk i bën mirë askujt. Të gjitha investimet financiare duhet të bëhen me kujdes dhe me konsultim të duhur për të shmangur humbjet e panevojshme.

### GAFORJA

Një marrëveshje e re financiare do të finalizohet duke ju sjellë më shumë të ardhura. Një partneritet i ri do të ishte premtues sot. Një ditë për lëvizje të kujdesshme në dashuri.

### LUANI

Situatë e mirë financiare për të lindurit në shenjë tuaj. Nëse keni investuar në projekte të qëndrueshme ekonomike gjatë jetës së mëmë të ardhura të mira. Edhe në dashuri do të merrni mesazhe pozitive.

### VIRGJERESHA

Përdorni terapinë buzëqeshje për të kuruar sëmundjet që kanë të bëjnë me dashurinë. Ju duhet të kurseni paratë për të ardhmen, përndryshe do të futeni në telashe financiare.

### PESHORJA

Ditë e mirë për të vizituar një avokat dhe për të marrë disa këshilla ligjore. Sot, do ta kaloni kohën më të mirë të jetës tuaj me bashkëshortin ose bashkëshorten. Do të keni fat në çështjet e parave.

### AKREPI

Shëndeti i prindërve mund të shkaktojë shqetësim. Përdorni idetë tuaja inovative për të bërë disa para shtesë. Ka shumë gjasa që të përballeni me kritika në shtëpi për shkak të sjelljes tuaj të pakujdesshme.

### SHIGJETARI

Shmangni agresivitetin veçanërisht në vendin e punës. Mirësjellja nuk është aspak dobësi, përkundrazi. Në dashuri duket se kohët e fundit keni kaluar një periudhë të vështirë.

### BRICJAPI

Ka të ngjarë të gëzoheni për suksesin e njerëzve të tjerë duke i lavdëruar ata. Por ndërkohë ende nuk po shikoni frytet e punës tuaj. Ndoshta nuk po e përdorni të gjithë potencialin tuaj.

### UJORI

Shmangni stresin dhe tensionin, sepse rrezikoni të dëmtoni shëndetin. Sa i përket parave tregoni shumë kujdes, sepse mund të shkaktoni gropa financiare të rraueshme. Edhe në dashuri do të duhet të prisni pak më shumë.

### PESHQIT

Tregoni më shumë angazhim në çështjet e dashurisë. Mos u tregoni kokëfortë. Toleranca është diçka pozitive. Në punë një person që e keni konsideruar armik do të rezultojë një aleat shumë i mirë.

Kryeministria e Serbisë: Duhet të gjendet kompromis për Kosovën

# Sot takimi me Vuçiç, Thaçi: Nëse na njohin si shtet, marrëveshja ka kuptim

Deputeti gjerman: Nëse bien dakord, do pranojmë vendimin

Pas një pritjeje kaq të gjatë, të gjithë ditën e sotme i kanë sytë nga takimi që do të bëhet mes dy presidentëve të dy vendeve, Vuçiç dhe Thaçi në Kosovë. Ndërkaq, Ministria për Punë të Jashtme e Kosovës ka miratuar kërkesën e presidentit të Serbisë, Aleksandar Vuçiç që të vizitojë Kosovën këtë fundjavë. Lajmin për Radion 'Evropa e Lirë' e ka konfirmuar Jetlir Zyberaj, këshilltar i lartë i ministrit të Jashtëm të Kosovës, Behgjet Pacolli. Zyberaj tha se leja për vizitë të Vuçiçit është lëshuar konform marrëveshjes së arritur në Bruksel, mes Kosovës dhe Serbisë, për lëvizje të lirë. Presidenti serb, Vuçiç pritet të këndojë në Kosovë më 8 dhe 9 shtator, ku pritet të takohet me banorët serbë në veri të vendit. Ndërsa për sa i përket takimit të sotëm, të shumta kanë qenë reagimet. Një ndër to ka qenë dhe kryeministria e Serbisë, Ana Bërnbaj, e cila në prag të vazhimit të dialogut në Bruksel, tha se asgjë nuk është "në tryezë" për momentin, përveç se duhet të arrihet një zgjidhje kompromisi për Kosovën. Ajo shtoi se do të dëshironte që të shkohet shpejt drejt kësaj zgjidhjeje, por shtoi se nuk e dinë se do të ndodhë kjo. E pyetur nëse të premtën në Bruksel në takimin e presidentit serb të Kosovës Hashim Thaçi dhe atij serb Aleksandar Vuçiç



do të flitet për një kompromis dhe ç'ka pret nga ky takim, Bërnbaj në një intervistë për Al-Jazeera Balkans tha: "Nuk pres ndonjë gjë në veçanti, por jam e habitur që po flasim për një kompromis, është një risi". Një tjetër reagim ka ardhur nga deputeti i së Majtës në Bundestagun Gjerman,

Stefan Liebich, nuk është për këmbimin e territoreve mes Kosovës dhe Serbisë, por, nëse dy vendet bien dakord, me njëri-tjetrin atëherë ne do ta pranojmë vendimin e tyre. "Ne nuk jemi fuqi koloniale. Janë shtete sovranë dhe mund të vendosin vetë, nëse duan ta bëjnë, ne duhet ta pra-

nojmë. Edhe më parë ka pasur raste të tilla, si për shembull kur Çekosllovakia u bë Çeki dhe Sllovakia, para pak kohësh u krijua Sudani i Jugut. Gjëra të tilla janë të mundshme, juridikisht korrekte dhe ne duhet t'i pranojmë. Por unë personalisht mendoj se këto nuk i zgjidhin konflik-

**TAKIMI**  
"Nuk pres ndonjë gjë në veçanti, por jam e habitur që po flasim për një kompromis, është një risi". Një tjetër reagim ka ardhur nga deputeti i së Majtës në Bundestagun Gjerman, Stefan Liebich, i cili nuk është për këmbimin e territoreve mes Kosovës dhe Serbisë, por nëse dy vendet bien dakord me njëri-tjetrin, atëherë do të pranohet vendimi.

tet e brendshme të secilit vend",-ka thënë deputeti i majtë gjerman. Ndër gjithë reagimet e deklaratat, s'kishte se si të mungonte ai i vetë presidentit të Kosovës. Hashim Thaçi në konferencën e pestë të ambasadorëve që po mbahet në Prishtinë ka folur sërish për çështjen e korrigjimit të

kufijve me Serbinë si dhe dialogun me këtë shtet. Kreu i shtetit kosovar tha se marrëveshje përfundimtare me Serbinë është shumë vështirë, ndërsa shtoi se ajo mund të realizohet të arrihet dhe ka pak gjasa të ndodhë, por sipas tij arritja e një marrëveshjeje të tillë ka kuptim vetëm në Kosova njihet nga Serbia dhe anëtarësohet në Organizatën e Kombeve të Bashkuara. Ai tha se arritja e një marrëveshjeje përfundimtare Kosovë-Serbi, ligjërisht e obligueshme nuk do të jetë e lehtë, por sipas tij, është e vetmja mundësi për të ecur para në integrimet euro-atlantike. "Asnjëherë nuk kemi lejuar që në Bruksel të hapet çështja e shkëmbimit të kufijve.... S'ka ndarje, s'ka shkëmbim të territoreve, s'ka asociacion me kompetenca ekzekutive",-tha Thaçi, por sipas tij, vetëm korrigjim të kufijve. Sipas tij, aktualisht është krijuar një moment i ri ndërkombëtar për një marrëveshje Kosovë-Serbi, ligjërisht e obligueshme dhe të mbylltet kapitulli i luftës ndërmjet dy vendeve. Ai tha se është momenti i hapjes së temës së bashkëngjites së territorit të Luginjës me Kosovën. Presidenti i vendit më tej tha se qdo hap i palës kosovare do të jetë i bashkërenduar me bashkësinë ndërkombëtare, me SHBA-të dhe Brukselin.

Daçiç: Kosova në dokumentet europiane është territor, jo shtet

## Ministri i Mbrojtjes, deklaratë të fortë: Shqiptarët trimërohen vetëm kur s'është Vuçiç



**ALEKSANDËR VULIN**

Shqiptarët janë trima vetëm kur janë larg Vuçiçit, por ndryshe janë kur paraqiten në negociata para kamerave"- ka thënë Vulin.

referohet territorit Kosovë",-tha Daçiç. Ndërkaq lidhur me takimin e sotëm, ministri i Mbrojtjes në Serbi, Aleksandër Vulin ka bërë thirrje tek autoritetet e Prishtinës që të mos men-

**IVICA DAÇIÇ**  
"Kosova nuk është anëtare e KB-së, as e OSBE-së dhe as e BE-së. Kosova në dokumentet europiane shënohet si territor e jo si shtet. MSA që është nënshkruar për Kosovën nuk i njëjtit me atë që e ka nënshkruar Serbia, edhe liberalizmi i vizave i referohet territorit Kosovë", -tha Daçiç.


"Shqiptarët janë trima vetëm kur janë larg Vuçiçit, por ndryshe janë kur paraqiten në negociata para kamerave"- ka thënë Vulin. Ky reagim i Vulinit ka ardhur pas deklaratave të kreut të Kuvendit Kardi Veseli, i cili ka thënë se mund t'i refuzohet kërkesa presidentit serb për t'u futur në Kosovë. Vulin ka thënë se vizita e Vuçiçit në Kosovë është për t'i kontribuar paqes dhe stabilitetit në rajon.

Sekretari i NATO-s në Maqedoni: Votoni referendumin

Ndërkombëtarët në mbështetje të referendunit, Zaev: Qytetarët do dinë të vendosin

Jens Stoltenberg, sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, vizitoi këtë të enjte Maqedoninë, në prag të referendunit për marrëveshjen e emrit me Greqinë. Shefi i aleancës ushtarake u dha maqedonasve mesazhin e qartë se anëtarësimi në NATO, por edhe perspektiva europiane, kalon pikërisht nga vota popullore e të 30 shtatorit. "Nëse e implementoni marrëveshjen për emrin, ju do të bëheni shtet anëtar i NATO-s. Shpresoj se herën tjetër kur do jem këtu do të vij një vend anëtar të aleancës". Për disa javë do të keni referendun ku duhet të vendosni për ardhmërinë, për anëtarësim në NATO dhe në Bashkimin Europian. NATO është e gatshme t'iu pranojë si anëtarin e 30-të NATO-s". Pas Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s, Maqedoninë të premtën e vizitit kancelari austriak Sebastian Kurz, për t'u pasuar më pas nga vizita e së shtunës e Kancelares gjermane Angela Merkel. 30 shtatori po afrohet dhe partitë në Maqedoni kanë ndezur motorët për fushatën finale para referendunit. Takime të shumta po zhvillohen për të bindur qytetarët se "mbështetja për marrëveshjen me Greqinë dhe suksesin i referendunit janë mundësi e vetme për të ardhmen evropiane të vendit". Opozita maqedonase ende vazhdon të kundërshtojë Marrëveshjen me Greqinë duke e quajtur "kapitulluesë për vendin, gjuhën, identitetin dhe kulturën maqedonase", por ajo deri më tani nuk ka dalë me qëndrimin nëse do të bojkotojë referendumin apo do të ftojë qytetarët që të votojnë kundër. Serbia e vizitave ndërkombëtare në Maqedoni filloi të mërkurën në mbërmje me vizitën në Shkup të Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s Jens Stoltenberg, sot viziton Shkupin, kancelari austriak Sebastian Kurz, ndërsa të shtunës Kancelarja gjermane Angela Merkel, vizita e së cilës vlerësohet si historike nga autoritetet e Maqedonisë. Gjermania konsiderohet si një nga shtetet që më së shumti ka mbështetur zgjidhjen e kontestit të emrit me Greqinë si dhe procesin e anëtarësimit të Maqedonisë në NATO dhe BE. Kryeministri Zaev ka shprehur besim të madh se më 30 Shtator, qytetarët do të marrin vendim të drejtë për ardhmërinë e tyre dhe ardhmërinë e shtetit.

**Fjalëkryqi (1)**



**HORIZONTAL**

- Irene aktore.
- Gjysma e kulmit.
- Fillojnë vjetër.
- Qytet rumun.
- Mund të jenë me sahat.
- Elliott Gould.
- Inicialet e Altman regjisor.
- Thomas Alva shpikës i famshëm.
- Lumë në Spanjë.
- Ndasheshin me sinorë.
- Zbuloi Tokën e Van Diemen.
- Kush nuk ka... nuk i ecën.
- Një kapak me titull.
- Inicialet e Turgeniev.
- Janë provat që administrohen.
- Na kanë paraprirë.
- Rubinstein që çie pianist.
- Fundi i një fukarai.
- Gardner aktore.
- Këndon me Paolan.

- Mish pa kocka.
- Mbahet në fund.
- Diftong teorik.
- E drejta romake.
- Eshtë transporti si kamion.
- Eastwood i kinemasë.
- I vocërr ai i Migjenit.
- Eshtë numri 1.
- Eshtë aftësia e kondensatorit
- Janë ciganët.

**VERTIKAL**

- Eshtë material për qiri.
- Mali ku ngeci Arka e Noes.
- Fillojnë panikun.
- Një zakon.
- Gjysmë sistem.
- Janë zogj të verdhë.
- Në fund të krahot.
- Shkroi Michel Strogoff.
- Gjysmë egoist.
- Përbindëshi i labirintit.
- Vertetojnë firma të tillë.
- Emri i Zola.
- Eshtë si shtëpi.
- Mbyllin portat.
- Ka tribuna me shkallë.
- Mund të jetë telefonike.
- Charles që krijoi Gishton.
- Pineda e Garcia Lorca-s.
- Janë të patëvizshmet.
- Aty ku del kush bie në sy.
- Ashtu si jeton anakoretit.
- Coca... më e famshme.
- Janë të ndryshme në leje.
- Ente Civile Kavajë.
- Shkroi Mlsteret e Parisit.
- Beton pa kufij.
- Kështu përfundon një princip.
- Inicialet e Cruise.
- Kufizojë lëvizjet.

**Fjalëkryqi (2)**


**HORIZONTAL**

- Një pjesë e perandorisë.
- Duhen marrë kolegjalisht.
- Qytet rus.
- Fillojnë daljen.
- Të lë në mëdyshe.
- Një pjesë teatrale për të qeshur
- Eshtë publiku i San Siros.
- Janë botimet e përmuajshme.
- Mbyllin aeroporte.
- Në krye të titullarëve.
- Ishte gruaja që i dha ujë nga pusi Krishtit
- Bëjnë zoom të tillë.
- Inicialet e Kazan regjisor.
- Centrale Autonome Daneze.
- Eshtë e kundërt e analizës.
- Qe mjeku i Mark Aurelit.
- Një enë.
- Pulat pa kufij.


- Eshtë për të ushqyer foshnjat me qumsh.
- Emri i Pirandellos.
- Një fjalë si akoma
- Në mes të Salt dhe City
- Jean që çë aktor.
- Mbyllin takimet
- Eshtë edhe ajo e cirkut
- Kapiteni i Nautilus.
- ... mosketierët e Dumas.

**VERTIKAL**


- Një fjalë e pamjaftueshme.
- Qe fabulist i famshëm
- Janë ciganët.
- Hapin vallen.
- Eshtë influencim.
- Janë amatorët
- Pak ilaritet
- Një pjesë e mendimeve.
- Eshtë budallaçka.
- Një fjalë e freskët.
- Një emër i njohur i modës.
- Me Odiseun u vodhi Palladin trojanëve.
- Elvira aktore.
- Pal... ish futbolli i yni.
- Një pjesë e dardanëve.
- Eshtë marsejeze... për çati.
- Eshtë ylli më i shndritshëm i Akrepit
- Liam aktor
- Mund të jetë një koncert.
- Kështu flet ai që është mbi kalë.
- Janë shtetet e ndara nga feja.
- Sean aktor.
- Stoker që shkroi Dracula.
- Një që bëhet si favor.
- Tre në Genesaret.
- Mbarojnë fare
- Diftong për serioz.



**Gjeni ndryshimin**



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

**PËRGJIGJET E FJALËKRYQVEVE TË NUMRIT TË KALUAR**

**FJALËKRYQI (1)**

**FJALËKRYQI (2)**

S	T	A	K	I	M	T	O	P	F
L	L	L	I	E	K	O	N	O	M
E	P	I	T	E	R	A	T	Z	A
M	A	S	A	T	F	I	N	A	L
A	R	A	T	F	I	T	L	A	T
T	A	T	K	A	R	A	B	I	N
N	K	A	M	A	T	A	T	A	P
P	O	H	I	M	R	E	L	A	I
A	J	O	A	R	E	S	T	R	E
S	A	I	R	E	T	R	E	G	T
H	E	V	E	R	T	O	N	T	E
A	T	L	E	T	E	M	A	R	I
T	A	N	D	E	M	M	I	S	A
E	P	E	R	S	I	A	V	E	N
K	N	A	T	I	N	Q	A	R	K
T	O	H	O	M	O	N	I	M	E
U	V	H	I	T	R	E	S	T	A
K	A	T	O	L	I	K	E	L	O
K	E	N	E	T	A	I	P	A	R
G	A	Z	E	T	A	A	E	N	I
N	E	T	R	E	N	D	O	R	K
E	T	U	E	E	A	N	T	E	N
R	E	A	K	T	E	T	I	T	E
A	E	D	I	T	A	R	T	A	R

**SUDOKU**

			3	5		2	9	
		8	4		6		7	
	5	6	9			8		
5				2	9			3
2		9				6		4
1			6	3			5	2
	3				7	5	6	
9			8		3	1		
7	2		9	1				8

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

**Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar**

6	9	4	3	1	7	2	5	8
3	1	8	5	2	6	9	4	7
5	2	7	8	4	9	6	3	1
7	8	5	2	6	3	1	9	4
1	3	6	9	8	4	5	7	2
9	4	2	7	5	1	8	6	3
4	5	3	1	9	2	7	8	6
2	6	9	4	7	8	3	1	5
8	7	1	6	3	5	4	2	9

*Argëtim filozofik*

- Askush nuk është i kënaqur me fatin e tij, edhe nëse ai është i mirë. Dhe askush nuk është i pakënaqur nga mendja e tij, edhe nëse është më e keqja.
- Optimist është një njeri që sheh dritë atje ku nuk ka. Pesimist është budallai i cili përpiqet ta shuajë.
- Veprimi nuk buron nga mendimi, por nga gatishmëria për përgjegjësi.

**KRIPTOSKEME**

**KRIPTOSKEME**  
Përgjigja e numrit të djeshëm

C	E	L	P	O	H	I	M	C	E	P
A	C	P	O	L	E	M	I	K	A	L
K	O	K	E	R	D	A	R	K	A	
U	Q	R	P	E	H	T	E	N		
I	N	F	O	R	M	A	C	I	O	N
H	E	F	E	S	T	I	L	E	D	
D	I	K	T	A	T	U	R	E	E	R
P	R	T	A	E	R	R	U	T	A	
A	R	M	E	T	R	U	S	C		
N	I	I	A	C	A	D	E	T	I	
D	A	M	A	R	E	T	H	A	R	S
A	N	I	L	A	C	I	A	I	R	T

*Thënie të mençura*

- E qeshura nuk është vetëm një shprehje e gëzimit, por edhe mënyrë e maskimit të dhimbjes. Prandaj, nuk duhet të jeni gjithmonë të sigurt për arsyen që dikush është duke qeshur.
- Njeriu më i pa vlerë është ai i cili nuk arriti të gjejë një mënyrë për të të mbajtur pranë tij.
- Nga të ecurit kuptohet tjetri në është në udhën e vet.
- Dy gjëra të keni gjithmonë lart... Qëllimet tuaja dhe dinjtetit tuaj

